



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 96

Tiranë – E premte, 8 maj 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 263, datë 5.5.2026	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 8519
Dekret i Presidentit nr. 264, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8519
Dekret i Presidentit nr. 265, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8519
Dekret i Presidentit nr. 266, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8519
Dekret i Presidentit nr. 267, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8520
Dekret i Presidentit nr. 268, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8520
Dekret i Presidentit nr. 269, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8520
Dekret i Presidentit nr. 270, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8521
Dekret i Presidentit nr. 271, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8521
Dekret i Presidentit nr. 272, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8521
Dekret i Presidentit nr. 273, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8522

Dekret i Presidentit nr. 274, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8522
Dekret i Presidentit nr. 275, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8522
Dekret i Presidentit nr. 276, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8522
Dekret i Presidentit nr. 277, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8523
Dekret i Presidentit nr. 278, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8523
Dekret i Presidentit nr. 279, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8523
Dekret i Presidentit nr. 280, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8524
Dekret i Presidentit nr. 281, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8524
Dekret i Presidentit nr. 282, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8524
Dekret i Presidentit nr. 283, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8525
Dekret i Presidentit nr. 284, datë 5.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8525
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 309, datë 29.4.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 833, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e standardeve e të kriterëve që mundësojnë zbatimin e parimit të shkencës së hapur dhe janë në përputhje me politikat e Zonës Evropiane të Kërkimit”	8525
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Punëve të Brendshme, i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe i drejtorit të Shërbimit Informativ të Shtetit nr. 91, datë 30.4.2026	Mbi bashkëpunimin e strukturave të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit, për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt	8529
Urdhër i Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 88, datë 8.5.2026	Për delegim kompetence.....	8545
Urdhër i ministrit të Arsimit nr. 122, datë 29.4.2026	Për miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Arsimit 2026–2029.....	8545
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 466, datë 29.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetën e Polonisë.....	8567

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 467, datë 29.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	8569
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 469, datë 30.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	8570
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 470, datë 30.4.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	8572
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 9.3.2026	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1923 (290), datë 21.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	8574
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 235, datë 6.5.2026	Për disa shtesa në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, i ndryshuar.....	8582
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit nr. 17, datë 7.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	8583

**DEKRET****Nr. 263, datë 5.5.2026****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Genci Kristaq Çapi
2. Aleksandra Lazer Fusha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 264, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Yekbun Eren Celal Gürhan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 265, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Batuhan Bilgehan Demirdöver

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 266, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Serap Adalet Fikri Hildir

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 267, datë 5.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Christopher Patrick Jerry L. Milligan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 268, datë 5.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Michele Marie Yuchengco Peter Sycip Dee

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 269, datë 5.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Luis Miguel Dee Emmanuel Justo Revilla Santos



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 270, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Rajan Bujar Baraliu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 271, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Inara Hajdar Letaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 272, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Elda Agim Vladi

2. Diana Luan Shuteriqi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 273, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Isni Hartel Visha
2. Maringlen Lek Toma

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 274, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Aydin Hecer Akdoğan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 275, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Tea Mentor Gola Dafota

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 276, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Kejsi Artur Steffen
2. Lulzim Bashkim Tulani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 277, datë 5.5.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Dario Namik Mulliqi
2. Jetëdona Osman Shahini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 278, datë 5.5.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Hayrettin Süleyman Şen

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 279, datë 5.5.2026

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Kadir Kerem Ilker Kanat



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 280, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Deniz Onur Hayrettin Resat Köymen

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 281, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Kaan Bilgehan Demirdöver

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 282, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Cenk Rüstem Eyüboğlu

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 283, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Genta Ilir Allushi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 284, datë 5.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Berivan Hasan Oğhan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 309, datë 29.4.2026****PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN
NR. 833, DATË 30.12.2025, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STANDARDEVE E TË KRITEREVE QË
MUNDËSOJNË ZBATIMIN E PARIMIT
TË SHKENCËS SË HAPUR DHE JANË
NË PËRPUTHJE ME POLITIKAT E
ZONËS EVROPIANE TË KËRKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 5, të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 833, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 2, të kreut I, shtohen pikat 3 dhe 4, me këtë përmbajtje:

“3. Zbatimi i parimit të shkencës së hapur për përmbushjen e politikave të Zonës Evropiane të Kërkimit, në lidhje me pjesëmarrjen e shtetit shqiptar në një Konsorcium Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (KEIK/ERIC) realizohet në përputhje me rregulloren e Këshillit (BE) nr. 723/2009, datë 25 qershor 2009, e ndryshuar me rregulloren (BE) nr. 1261/2013, datë 2 dhjetor 2013, dhe legjislacionin kombëtar.

4. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 723/2009, e ndryshuar me rregulloren (BE) nr. 1261/2013”, rregullorja që përcakton kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian për krijimin e konsorciumeve evropiane të infrastrukturës së kërkimit (ERIC), duke vendosur kërkesat, procedurat e pasojat juridike, që lidhen me



themelimin, funksionimin dhe statusin e tyre, me qëllim mundësimin e ngritjes e të operimit të infrastrukturave kërkimore me interes të përbashkët evropian, në mbështetje të zhvillimit të Konsorciumit Evropian të Infrastrukturës Kërkimore;

b) “Infrastrukturë kërkimore”, objektet, burimet dhe shërbimet përkatëse, që përdoren nga persona juridikë dhe/ose kërkuesit shkencorë, që zhvillojnë veprimtari të kërkimit shkencor, për kryerjen e kërkimeve të nivelit të lartë në fushat përkatëse, duke përfshirë dhe pajisjet shkencore madhore ose grupe instrumentesh; burime të bazuara në njohuri, si: koleksione, arkiva ose struktura për informacion shkencor; infrastruktura të bazuara në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si: rrjete, sisteme kompjuterike, programe dhe komunikim, si dhe çdo njësi tjetër me natyrë të veçantë, e domosdoshme për arritjen e ekselencës në kërkim.

Infrastruktura të tilla mund të jenë të vendosura në një vend të vetëm ose të shpërndara në formën e një rrjeti të organizuar burimesh;

c) “Konsorcium Evropian i Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC)”, një subjekt juridik i krijuar në bazë të rregullores së Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar, që përbën një subjekt të së drejtës civile për krijimin dhe funksionimin e infrastrukturave kërkimore me interes evropian, i themeluar nga shtete anëtare, vende të asociuara, vende të treta ose organizata ndërqeveritare, me personalitet juridik për të realizuar veprimtari në fushën e kërkimit shkencor të zhvillimit teknologjik e demonstrimit, kryesisht mbi bazë joekonomike, për të mbështetur ekselencën shkencore, për të siguruar akses për komunitetin evropian të kërkimit e për të kontribuar në zhvillimin e hapësirës evropiane të kërkimit dhe që nuk konsiderohet organ i Bashkimit Evropian dhe as organ publik kombëtar, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në legjislacion;

ç) “Komunitet kërkimor”, kërkuesit shkencorë, institucionet e kërkimit, institucionet e arsimit të lartë dhe subjektet e tjera të së drejtës civile, që kryejnë veprimtari në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik, në nivel kombëtar, evropian ose ndërkombëtar;

d) “Kërkim shkencor i nivelit të lartë”, veprimtari kërkimore të kryera nga komuniteti shkencor, që përmbushin standarde të larta shkencore dhe teknologjike, dhe që synojnë arritjen e ekselencës në

kërkim, në përputhje me programet evropiane të kërkimit, zhvillimit teknologjik e demonstrimit;

dh) “Pajisje shkencore madhore”, pajisje, instrumente ose grupe instrumentesh me kompleksitet të lartë teknik dhe vlerë të konsiderueshme, të përdorura nga komuniteti shkencor për kryerjen e kërkimit shkencor të nivelit të lartë në kuadër të një infrastrukture kërkimore;

e) “Ekselencë në kërkim shkencor”, realizimi i veprimtarive kërkimore sipas standardeve më të larta shkencore e teknologjike, që kontribuojnë në përparimin e njohurive, forcimin e kapaciteteve kërkimore dhe zhvillimin e hapësirës evropiane të kërkimit;

ë) “Vend i tretë”, një shtet që nuk është shtet anëtar i Bashkimit Evropian;

f) “Vend i asociuar”, një vend i tretë, që është palë në një marrëveshje ndërkombëtare me Bashkimin Evropian, në bazë të së cilës ai jep një kontribut financiar për të gjithë ose një pjesë të Programeve Kornizë të Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Zhvillim Teknologjik;

g) “Vend anëtar i ERIC-ut”, një shtet që merr pjesë në një Konsorcium Evropian të Infrastrukturës Kërkimore (ERIC) me të drejta dhe detyrime të plota, në përputhje me rregulloren e Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar, statutin e ERIC-ut dhe vendimet e organeve të tij, përfshirë të drejtën e votës, përfaqësimin në organet drejtuese dhe detyrimin për të dhënë kontribute financiare ose kontribute të tjera të miratuara;

gj) “Vend vëzhgues”, shteti që merr pjesë në një Konsorcium Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC) pa të drejtë vote, në përputhje me kushtet e përcaktuara në statutin e tij, me të drejtë pjesëmarrjeje në veprimtaritë dhe organet përkatëse, sipas rregullave të brendshme të krijimit të Konsorciumit.”.

2. Pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

“III/1. Zbatimi i politikave të Zonës Evropiane të Kërkimit

1. Në zbatim të politikave të Zonës Evropiane të Kërkimit dhe të legjislacionit të Bashkimit Evropian në fushën e kërkimit e të inovacionit, si dhe të ligjit nr. 47/2022, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Evropian ‘Horizont Evropa’



– Programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin”, shteti shqiptar mund të marrë pjesë në infrastruktura kërkimore ndërkombëtare, si Konsorciumi Evropian i Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC), në përputhje me rregulloren e Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar.

2. Konsorciumi Evropian i Infrastrukturës së Kërkimit fiton personalitet juridik nga data e njoftimit të vendimit për krijimin e tij, në përputhje me rregulloren e Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar.

3. Veprimtaria e një Konsorciumi Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC) ushtron detyrën kryesore mbi bazë joekonomike; megjithatë, ai mund të zhvillojë edhe veprimtari ekonomike të kufizuara, me kusht që kjo veprimtari të jetë e lidhur ngushtë me detyrën kryesore të tij dhe të mos cenojë realizimin e saj.

4. Infrastruktura kërkimore, që krijohet në kuadër të një Konsorciumi Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC), duhet të plotësojë këto kërkesa:

a) Të jetë e nevojshme për realizimin e programeve dhe të projekteve evropiane të kërkimit, përfshirë zbatimin efektiv të programeve të komunitetit për kërkim shkencor, zhvillim teknologjik e demonstrim;

b) Të përfaqësojë një vlerë të shtuar në forcimin e strukturimin e Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe të përbëjë një përmirësim të rëndësishëm në fushat përkatëse shkencore dhe teknologjike në nivel ndërkombëtar;

c) Të garantojë akses efektiv, në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutin e tij për komunitetin evropian të kërkimit të përbërë nga kërkues shkencorë nga shtetet anëtare dhe nga vendet e asociuara;

ç) Të kontribuojë në lëvizshmërinë e njohurive dhe/ose të kërkuesve brenda Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA) dhe të rrisë përdorimin e potencialit intelektual në të gjithë Evropën;

d) Të kontribuojë në përhapjen dhe optimizimin e rezultateve të veprimtarive, në kuadër të programeve të komunitetit për kërkim shkencor, zhvillim teknologjik e demonstrim.

5. Subjektet, që aplikojnë për krijimin e një Konsorciumi Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC), paraqesin një kërkesë pranë Komisionit Evropian.

Kërkesa paraqitet me shkrim në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian dhe përmban:

a) kërkesën drejtuar Komisionit për krijimin e ERIC-it;

b) projektstatutin e ERIC-it, sipas përcaktimeve të nenit 10 “Statuti”, të rregullores;

c) përshkrimin teknik dhe shkencor të infrastrukturës kërkimore, që do të krijohet e administrohet/përdoret nga ERIC-u;

ç) një deklaratë nga shteti pritës, me anë të së cilës ERIC-u njihet si organizëm ndërkombëtar, në kuptim të neneve 143(g) dhe 151(1)(b) të direktivës 2006/112/EC, dhe si organizatë ndërkombëtare në kuptim të nenit 23(1), paragrafi i dytë i direktivës 92/12/EEC, që nga momenti i krijimit të tij, të përafuar me legjislacionin në fuqi në fushën për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe për akcizat.

Kufizimet dhe kushtet e përjashtimeve të parashikuara në këto dispozita përcaktohen në një marrëveshje ndërmjet anëtarëve të ERIC-it.

Komisioni Evropian vlerëson kërkesën në përputhje me rregulloren.

6. Anëtarësimi në një Konsorcium Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC) rregullohet, si më poshtë vijon:

a) ERIC-u përfshin një shtet anëtar të Bashkimit Evropian dhe dy shtete të tjera, të cilat janë shtete anëtare ose vende të asociuara;

b) Shtete të tjera anëtare ose vende të asociuara mund të bëhen anëtare në çdo kohë, sipas kushteve të përcaktuara në statutin e ERIC-it, si dhe mund të marrin pjesë si vëzhgues, pa të drejtë vote, sipas kushteve të përcaktuara në të;

c) Vendet e treta, të ndryshme nga vendet e asociuara, si dhe organizatat ndërqeveritare mund të bëhen anëtare të ERIC-it, me miratimin e asamblesë së anëtarëve, në përputhje me kushtet e procedurat për ndryshimin e anëtarësisë, të përcaktuara në statutin e tij;

ç) Shtetet anëtare ose vendet e asociuara mbajnë së bashku shumicën e të drejtave të votës në asamblenë e anëtarëve;

d) Për ERIC-un, me seli statutore në territorin e një shteti anëtar, propozimet për ndryshimin e statutit miratohen nga shumica e shteteve anëtare që janë anëtarë të tij;

dh) Shtetet anëtare, vendet e asociuara ose vendet e treta mund të përfaqësohen në ERIC nga një ose më shumë subjekte publike, përfshirë njësi të vetëqeverisjes vendore ose nga subjekte private, që



ushtrojnë funksione në shërbim publik, për ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësia në ERIC;

e) Vendet e asociuara, vendet e treta dhe organizatat ndërqeveritare, që aplikojnë për krijimin ose për anëtarësimin në një ERIC, njohin personalitetin juridik e kapacitetin juridik të tij, si dhe pranojnë që ai t'u nënshtrohet rregullave të përcaktuara nga legjislacioni i zbatueshëm;

ë) Vendet e asociuara dhe vendet e treta, që aplikojnë për krijimin ose për anëtarësimin në një ERIC, i garantojnë ERIC-ut trajtim të barasvlershëm me atë që rrjedh nga zbatim i neneve përkatëse të rregullores së Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar, për njohjen e personalitetit juridik dhe statusit të tij si organizatë ndërkombëtare.

7. Në statut, në përputhje me rregulloren e Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar, përcaktohen elementet thelbësore të organizimit e të funksionimit të Konsorciumit Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC), duke përfshirë, në veçanti, listën e anëtarëve dhe të vëzhguesve, kushtet e procedurat për ndryshimin e anëtarësisë dhe të përfaqësimit, detyrat dhe veprimtaritë, selinë, emërtimin, organet drejtuese, kohëzgjatjen dhe procedurën e shpërbërjes së organeve, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve, përgjegjësitë e tyre, kompetencat dhe mënyrën e përfaqësimit ligjor, politikat e funksionimit, rregullat financiare, gjuhën ose gjuhët e punës, si dhe çdo element tjetër të kërkuar nga rregullorja përkatëse e Bashkimit Evropian.

8. Konsorciumi Evropian i Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC) harton raportin vjetor të veprimtarisë, i cili përfshin, në veçanti, aspektet shkencore, administrative e financiare të veprimtarisë së tij. Raporti miratohet nga asambleja e anëtarëve dhe u përcillet Komisionit Evropian dhe autoriteteve publike përkatëse brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i vitit financiar përkatës.

9. Krijimi dhe funksionimi i brendshëm i një Konsorciumi Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC) rregullohet, si më poshtë:

a) Nga e drejta e Bashkimit Evropian, në veçanti, nga rregullorja (BE) nr. 723/2009, e ndryshuar, si dhe nga vendimet e miratuara në zbatim të saj;

b) Nga legjislacioni i shtetit në territorin e të cilit ERIC-u ka selinë statutore, për çështjet që nuk

rregullohen ose rregullohen pjesërisht nga aktet e përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike;

c) Nga statuti i ERIC-ut dhe aktet e miratuara për zbatimin e tij.

10. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion për mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve në lidhje me ERIC-un, ndërmjet anëtarëve dhe ERIC-ut, si dhe për çdo mosmarrëveshje, në të cilën është palë Bashkimi Evropian.

11. Legjislacioni i Bashkimit Evropian për juridiksionin zbatohet për mosmarrëveshjet ndërmjet ERIC-ut dhe palëve të treta. Në rastet që nuk mbulohen nga legjislacioni i Bashkimit Evropian, juridiksioni kompetent përcaktohet sipas legjislacionit të shtetit në territorin e të cilit ERIC-u ka selinë statutore.

12. Në rast shkeljeje të rregullores ose të mosrealizimit të detyrës, Komisioni Evropian mund të shfuqizojë vendimin për krijimin e Konsorciumit Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC).

13. Aplikimi për pjesëmarrjen e shtetit shqiptar si anëtar ose për themelimin e një Konsorciumi Evropian të Infrastrukturës së Kërkimit (ERIC), i përfaqësuar nga një ose më shumë subjekte të së drejtës civile, paraqitet pranë Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI).

14. AKKSHI shqyrton aplikimin në përputhje me rregulloren e Këshillit (BE) nr. 723/2009, të ndryshuar, dhe pas vlerësimit pozitiv, ia paraqet atë për shqyrtim Këshillit Kombëtar për Shkencën, Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (KKSHKSH).’’.

II. Ngarkohen ministria përgjegjëse për kërkimin shkencor, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet, që zhvillojnë kërkim shkencor, të financuara apo të bashkëfinancuara me fonde publike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Albana Koçi

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 91, datë 30.4.2026****MBI BASHKËPUNIMIN E
STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR
EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME,
MINISTRISË SË PUNËVE TË
BRENDSHME DHE SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT, PËR
PROCEDURAT E LËSHIMIT TË VIZAVE
PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 22, pika 5, nenit 24, pika 2, nenit 25, pika 6, nenit 28, pika 2, nenit 29, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858/2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për lëshimin e vizave, hyrjen, qëndrimin dhe tranzitimin e shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, ministri i Punëve të Brendshme, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit

UDHËZOJNË:**I. INSTITUCIONET E PËRFSHIRA NË
PROCEDURËN E LËSHIMIT TË VIZAVE
PULLË DHE ELEKTRONIKE**

1. Autoritetet përgjegjëse, që bashkëpunojnë në procesin e lëshimit të vizave pullë dhe elektronike për hyrjen, qëndrimin dhe kalimin tranzit të të huajve në Republikën e Shqipërisë, janë:

- a) në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më poshtë MEPJ) – Drejtoria e Çështjeve Konsullore (më poshtë “DÇK”) dhe misionet diplomatike dhe postet konsullore (më poshtë “MDPK”) të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit;
- b) në Ministrinë e Punëve të Brendshme (më poshtë “MPB”) – Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (më poshtë “DKM”);
- c) Shërbimi Informativ i Shtetit (më poshtë “SHISH”).

2. Brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, autoritetet e sipërpërmendura bashkëveprojnë për

çështjet që lidhen me trajtimin e aplikimeve për viza, hyrjen, qëndrimin dhe kalimin tranzit të të huajve, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim. Aplikimi për vizë, në të gjithë statuset nëpër të cilat procedohet, do të konsiderohet konfidencial dhe nuk mund të jepet informacion i detajuar, përveç atij në sistemin *e-visa.al* apo në shërbimin e lejes unike. Gjatë procesit të verifikimit të aplikimit për vizë, është rreptësisht i ndaluar komunikimi i aplikuesit, ftuesit, apo i çdo subjekti tjetër me strukturat përgjegjëse, përveç rasteve kur këto struktura i kontaktojnë.

**II. PROCEDURA E APLIKIMIT PËR VIZË
NË MDPK**

1. Misionet Diplommatike dhe Postet Konsullore të RSH-së pranojnë kërkesat *online* për pajisje me vizë të shtetasve të atij vendi apo rezidentë në atë vend, sipas listës në aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858/2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, apo të përfaqësuesve të shoqërive turistike shqiptare ose të shtetasve të tjerë të huaj, sipas miratimit paraprak të DÇK-së, në MEPJ.

2. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesës për vizë pullë ose elektronike, të paraqitur *online* nga i huaji në MDPK-të, kryhet nga nëpunësi konsullor i autorizuar dhe i trajnuar për çështjet e vizave, si dhe i certifikuar për shqyrtimin e dokumentacionit të klasifikuar, i cili në rast dyshimi interviston të huajin për verifikimin e fakteve të paraqitura në kërkesë (më poshtë “Konsull”).

3. Aplikimi për vizë pullë ose elektronike pranohet kur dokumentacioni i ngarkuar *online* është në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, të ndryshuar. Konsulli kalon në parregullsi statusin e aplikimit kur konstaton se dokumentacioni nuk është i plotë, ose kur kërkon dokumentacion shtesë nëse e gjykon të arsyeshme. Arsyeja e parregullsisë i komunikohet të huajit elektronikisht nëpërmjet sistemit *e-visa.al*.

4. Në raste kur i huaji aplikon për leje unike, aplikimi për vizë pullë ose elektronike bëhet *online* nëpërmjet shërbimit të lejes unike në *e-albania.al*, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 858/2021, të ndryshuar, duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm dhe mandat pagesën e tarifës së vizës, e cila është e pakthyeshme.



5. Pas paraqitjes së aplikimit, konsulli kryen verifikimin e plotësimit të kriterëve ligjore dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës:

a) në rastet kur aplikimi nuk përmbush kriteret, konsulli e kalon aplikimin në statusin parregullsi, duke bërë shënime përkatëse dhe duke udhëzuar saktë aplikuesin nëpërmjet shënimeve në sistemin *e-visa.al*;

b) në rastet kur aplikanti nuk reflekton dokumentacionin sipas kriterëve dhe udhëzimeve të konsullit, për herë të tretë, konsulli ka të drejtë të refuzojë aplikimin;

c) në rastet kur aplikimi nuk përmbush asnjë kriter ligjor, konsulli ka të drejtë të refuzojë menjëherë aplikimin për vizë.

6. Pas pranimit të aplikimeve për vizë pullë ose elektronike dhe pagesës së tarifës së vizës, konsulli **brenda 1 (një) dite pune**, procedon aplikimet pranë DÇK-së. Në momentin e përcjelljes për vlerësim, Konsulli verifikon përsëri të dhënat në aplikim, duke vendosur prioritetin e trajtimit të aplikimit (normal, i lartë, shumë i lartë) dhe në rubrikën “shënime” vendos vlerësimin mbi dokumentacionin dhe mendimin (pozitiv, negativ apo i dyshuar). Ai mban përgjegjësi për saktësinë e përcjelljes së të dhënave.

7. Aplikimi për vizë elektronike përfundon me njoftimin e vendimit mbi kërkesën për vizë dhe në rast miratimi, me gjenerimin dhe përcjelljen elektronike të vizës. Aplikimi për vizë pullë, në rast miratimi në sistemin *e-Visa*, përfundon me njoftimin e vendimit mbi aplikimin dhe caktimin e datës dhe orës së paraqitjes në Misionin Diplomantik ose Postin Konsullor për tërheqjen e vizës. Afati për njoftimin e vendimit **është 5 (pesë) ditë pune** nga data e pagesës së tarifës së vizës në rastin e aplikimeve për leje unike dhe **4 (katër) ditë pune** në rastin e aplikimeve për leje qëndrimi, përveç rasteve kur parashikohen afate të tjera në marrëveshje ndërkombëtare.

8. Në rast se gjatë procedurës së pranimit të aplikimit *online* konstatohet paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, Konsulli refuzon dhënien e vizës, duke specifikuar në aplikim “REFUZUAR”, shënon datën e refuzimit, administron dokumentin e falsifikuar, si dhe informon zyrtarisht MEPJ-në për rastin e konstatuar dhe vepron sipas udhëzimeve që i jepen.

9. Në rastet e aplikimit për pajisje me leje unike për kategoritë e të huajve, që në bazë të ligjit i

nënshtrohen detyrimit për marrjen e miratimit të punësimit, aplikimi për vizë shqyrtohet pas miratimit të punësimit nga autoriteti përgjegjës për çështjet e punësimit.

10. Pas miratimit të punësimit, konsulli kryen verifikimin e përmbushjes së kriterëve ligjore dhe të dokumentacionit shoqërues për aplikimin për vizë:

a) në rast kur aplikimi për vizë ka mbërritur pa asnjë dokument nga FER-i ose konstatohen parregullsi në dokumentacion, konsulli e kalon në statusin “parregullsi konsulli”, duke bërë shënime përkatëse dhe duke udhëzuar aplikuesin nëpërmjet shënimeve në sistemin *e-visa.al*;

b) në rastet kur aplikanti nuk reflekton dokumentacionin sipas kriterëve dhe udhëzimeve të konsullit, për herë të tretë, konsulli ka të drejtë të refuzojë aplikimin;

c) afati për reflektimin e parregullsive në sistemin *e-Albania* dhe *e-visa.al* është **deri në 3 (tri) ditë pune**. Në rast të mos respektimit të këtij afati, sistemi refuzon automatikisht aplikimin për vizë.

11. Pas miratimit të vizës, në rastet e aplikimit për leje unike/qëndrimi, aplikimi i përcillet për shqyrtim dhe vlerësim autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin. Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimit kryhet pas hyrjes së të huajit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Vlefshmëria e vizës së miratuar fillon nga data e hyrjes së parë në territor e të huajit.

III. PROCEDURA E TRANSFERIMIT TË APLIKIMIT NË NJË MDPK TJETËR

1. Për interesa shtetërore, raste humanitare ose rrethana të tjera të justifikuara, aplikimet për vizë pullë dhe elektronike mund të pranohen në një MDPK të ndryshme nga lista e miratuar në aneksin 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, të ndryshuar. Transferimi i aplikimit bëhet pas miratimit nga DÇK-ja në MEPJ, për rastet, si më poshtë:

a) bazuar në kërkesën e aplikantit apo pritësit të tij, sipas formularit në aneksin nr. 1 dhe dokumentacionit mbështetës;

b) bazuar në kërkesën e paraqitur nëpërmjet postës zyrtare elektronike të DÇK-së;

c) në rastet kur DÇK-ja transferon rastet për arsye objektive të ndonjëres MDPK, pa pasur kërkesë nga vetë aplikantët.

2. **Brenda ditës së punës**, DÇK-ja shqyrton kërkesën për transferimin e aplikimit të të huajit së bashku me dokumentacionin mbështetës, merr



vendim dhe transferon aplikimin për vizë në sistemin *e-visa.al* ku shtetasi i huaj njoftohet me *email* për ndryshimin e kodit të aplikimit. Për miratimin e transferimit të aplikimit për vizë njoftohet MDPK-ja respektive që do të shqyrtojë aplikimin.

3. Në rast refuzimi, **brenda 5 ditëve pune** pas marrjes së njoftimit, të interesuarit kanë të drejtën e apelimit, duke paraqitur dokumentacion ose argumente shtesë. Kërkesa për apelim i drejtohet DÇK-së, bashkë me dokumentacionin shtesë në mbështetje të kërkesës për transferim. DÇK-ja shqyrton kërkesën për apelim dhe merr vendim **brenda 2 ditëve pune**, duke njoftuar përgjigjen me shkrim. Korrespondenca mund të kryhet dhe përmes postës elektronike. Me shqyrtimin e kërkesës për apelim, procesi i shqyrtimit të transferimit konsiderohet i përfunduar.

IV. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË APLIKIMEVE PËR VIZË

1. Nëpunësi i autorizuar për shqyrtimin e vizave në DÇK (më poshtë “nëpunësi shqyrtues”) kryen veprimet paraprake verifikuese për rregullshmërinë e aplikimeve të dërguara nga MDPK-ja dhe përcjell **brenda 1 dite pune** aplikimet për vlerësim në drejtim të DKM-së dhe SHISH-it në sistemin *e-Visa*.

2. DKM-ja shqyrton dhe verifikon kërkesat për vizë të përcjella nga MEPJ, duke konsultuar bazat e të dhënave të Policisë së Shtetit dhe profilet e hartuara nga analiza e riskut për vendet e origjinës. Kur vlerësohet e nevojshme, DKM-ja konfirmon me ftuesin ekzistencën e ftesës përkatëse për shtetasin e huaj.

3. **Brenda 4 (katër) ditëve punë në rastin e aplikimeve për leje unike dhe 3 (tre) ditëve punë në rastin e aplikimeve për leje qëndrimi**, DKM-ja dhe SHISH-i japin vlerësimin dhe vendimin e tyre në modulën *e-Visa*, nëse kërkesa duhet të miratohet ose refuzohet. DKM-ja dhe SHISH-i kanë të drejtë t’i kërkojnë DÇK-së zgjatje të afatit për vlerësim të aplikimit dhe **për 2 ditë të tjera pune**. Për raste të veçanta, kur është i domosdoshëm verifikimi i detajuar i të dhënave, afati i dhënies së mendimit nga DKM-ja dhe SHISH-i mund shtyhet edhe **për 2 ditë të tjera pune**.

4. Për vizë të tipit “C” – turizëm, trajtimi **brenda 1 (një) dite pune** për shtetet Bahrein,

Indonezi, Jordani, Oman dhe Tajlandë me dokumentacionin, si më poshtë:

a) Formulari i aplikimit;

b) Fotokopje e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar;

c) Fotografi e aplikuesit, e cila duhet të jetë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit me përmasa 47 mm x 36 mm (555px X 435 px X 300 DPI);

ç) Rezervim hoteli/akomodimi;

d) Deklarata sipas përcaktimeve ligjore, ku të shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestarit ligjor sipas legjislacionit në fuqi për udhëtimin e të miturit (për fëmijët minorenë).

5. Të gjitha përgjigjet në modulën *e-Visa* për refuzim vize nga ana e DKM-së dhe SHISH-it, duhet të arsyetohen me argumentimin përkatës ligjor mbi arsyet e refuzimit. Përgjigjet e dhëna grupohen duke respektuar rregullat, si më poshtë:

a) rregullshmëria e dokumentit të paraqitur të udhëtimit;

b) justifikimi i qëllimit dhe kushteve të udhëtimit;

c) dëshmia se zotëron mjete të mjaftueshme jetese për kohëzgjatjen e qëndrimit ose për rikthimin në vendin e origjinës/vendbanimit ose për të kaluar tranzit në një vend të tretë;

ç) respektimi i afateve në qëndrimet paraardhëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) dëshmia se zotëron siguracionet e përshtatshme mjekësore;

dh) besueshmëria e duhur për motivin e kërkesës dhe të kushteve të qëndrimit;

e) garantimi i detyrimit për të lënë territorin e Republikës së Shqipërisë para përfundimit të vlefshmërisë së vizës C (për qëndrim afatshkurtër);

ë) refuzim mbështetur në të dhënat që posedojnë strukturat përgjegjëse, sipas nenit 28, të ligjit, “Për të huajt”. Në rastin kur arsyeja e refuzimit është informacion i klasifikuar, trajtohet sipas ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, duke mos ekspozuar institucionin që ka dhënë arsyen e refuzimit.

6. Nëpunësi shqyrtues në DÇK, përcjell **brenda 1 dite pune** vendimin përfundimtar në MDPK-në përkatëse. Për vizat e refuzuara jepet arsyeja e argumentuar. Aplikanti njoftohet nga



MDPK-ja për refuzimin e vizës, si dhe për arsyen e këtij vendimi nëpërmjet sistemit *e-visa.al* ose me formularin si në aneksin nr. 2., i cili gjenerohet nga sistemi *e-visa.al*.

7. Për rastet e kërkesave për vizë nga personalitetet e njohura shtetërore, si dhe personalitete të shquara në fusha të ndryshme, vizita e të cilëve në Shqipëri vlerësohet si interes kombëtar, me rekomandimin e kreut të misionit ku kryhet aplikimi, DÇK-ja mund të japë miratimin me procedurë urgjente, **brenda 1 ditë pune**, duke mos kryer konsultime me strukturat e DKM-së dhe SHISH-it.

V. PROCEDURA E LËSHIMIT TË VIZËS PULLË DHE/OSE ELEKTRONIKE

1. Për të huajt që do të qëndrojnë në Shqipëri, për një periudhë mbi 90 ditë brenda 180 ditëve, lëshohet viza e qëndrimit e tipit D, me vlefshmëri 1-vjeçare dhe kohë qëndrimi 90 ditë, por jo më shumë se 180 ditë, sipas përcaktimeve të nenit 21, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar. I huaji bëhet me dije për procedurat, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Viza pullë, pas printimit nga sistemi *e-visa.al*, pozicionohet në një faqe të lirë të pasaportës. Faqja përballë të jetë, gjithashtu, e lirë. Pulla vendoset në mënyrë të tillë që fundi i saj të orientohet nga ana e jashtme e dokumentit.

3. Lëshimi/refuzimi i vizës, si dhe informacioni për vizën e lëshuar ruhen në sistemin *e-Visa*. Gjithashtu, informacioni i plotë për vizën e miratuar/refuzuar transferohet në sistemin TIMS (moduli hyrje/dalje) *online*. Pikat e Kalimit Kufitar (më poshtë “PKK”) duhet të kenë informacionin e plotë për vizën e lëshuar, para se i huaji të paraqitet për të hyrë në territor.

4. Në rastin e vizës elektronike, pas miratimit, kjo e fundi i përcillet aplikantit me anë të postës elektronike. Aplikanti e printon vizën nga cilido vend që ndodhet, me kushtin që të jetë jashtë territorit të RSH-së. Aplikuesi para hyrjes në territor duhet të paraqesë vizën elektronike të printuar nga *email*-i, si dhe dokumentin e identifikimit me të cilin ka aplikuar. Gjithashtu, vizën elektronike shtetasi i huaj duhet ta paraqesë edhe gjatë daljes nga territori i RSH-së në çdo PKK, me qëllim verifikimin e respektimit të afateve të vlefshmërisë së vizës.

5. Në rastin e vizës pullë, pas aprovimit, shtetasit duhet të paraqiten fizikisht në Misionin Diplomatik apo Postin Konsullor të RSH-së nga ku kanë kryer procedurën e aplikimit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në VKM-në nr. 858/2021, të ndryshuar.

6. Verifikimi i vizës elektronike kryhet nëpërmjet sistemit *e-visa.al* nga përdoruesit e tij, nëpërmjet aplikacionit *SQsign* ose nëpërmjet verifikimit manual në faqen zyrtare të *e-visa.al* (aneksi 4).

VI. PROCEDURA E LËSHIMIT TË VIZËS NË KUFI

1. Në rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, lëshimi i vizës në PKK bëhet me kërkesë të MEPJ-së, sipas procedurave në vijim:

a) kërkesa për pajisjen me vizë në kufi të shtetasve të huaj i drejtohet MEPJ-së nga institucionet shtetërore apo institucionet e tjera;

b) kërkesa duhet të përmbajë:

i. të dhëna të mjaftueshme për aktivitetin dhe argumentimin e interesit shtetëror ose detyrimeve ndërkombëtare;

ii. argumentimin për pamundësinë për pajisjen me vizë në PDK jashtë vendit;

iii. përmbushjen e detyrimeve dhe garancive ligjore të marrjes përsipër të akomodimit të të huajve të ftuar, qëndrimit dhe largimit të tyre brenda afateve të vizës së kërkuar;

iv. informacion për mbërritjen e të huajit, qëndrimin dhe largimin nga Shqipëria;

v. formularin e plotësuar për kërkesën për vizë në kufi, si në aneksin nr. 3;

c) pas vlerësimit të kërkesës, DÇK-ja i përcjell DKM-së, jo më vonë se 48 orë para lëshimit të vizës, kërkesën e miratuar për pajisjen me vizë në kufi të të huajit/ve, e cila duhet të përmbajë informacion mbi:

i. gjeneralitetet e personit/ave që kërkohet të pajiset/en me vizë;

ii. dokumentin e udhëtimit;

iii. llojin e vizës;

iv. afatin e lëshimit dhe të përfundimit të vlefshmërisë së vizës;

v. afatin e përdorimit;

vi. kushtin me/pa pagesë;

vii. PKK-ja ku do të lëshohet viza;

ç) DÇK-ja i dërgon njëkohësisht konfirmimin mbi vizën në kufi palës së interesuar, për të



lehtësuar qarkullimin e të huajve në kufijtë e shteteve të tjera;

d) DKM-ja përcjell menjëherë kërkesën për vizë në kufi në strukturat vendore të kufirit dhe migracionit, si dhe PKK-së ku i huaji do të paraqitet për marrjen e vizës dhe hyrjen në Shqipëri;

dh) përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë, sipas kërkesës së miratuar të MEPJ-së ardhur nëpërmjet DKM-së, duke kryer procedurat e zakonshme kufitare të verifikimit të hyrjes dhe të qëndrimit në RSH për shtetasit e huaj;

e) informacioni mbi vizën e dhënë regjistrohet në modulën përkatës të *e-Visa*;

ë) autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin i dërgon SHISH-it, në formë shkresore, informacion mbi vizën e dhënë deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Visa* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi;

f) autoriteti i PKK-së ka të drejtën e refuzimit të hyrjes/vizës, nëse se i huaji nuk i plotëson kushtet e hyrjes, kalimit tranzit dhe të qëndrimit në territorin e RSH-së. Për këtë njoftohet DÇK-ja dhe DKM-ja.

2. Në rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, pas procedurës së aplikimit *online* për vizë në kufi në sistemin *e-visa.al*, përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë elektronike/pullë tranzit të huajt, anëtarë të mjeteve të lundrimit, të cilët kërkojnë të imbarkohen apo riimbarkohen në një nga portet shqiptare, sipas procedurave në vijim:

a) i huaji, anëtar i mjetit të lundrimit dhe agjencia shqiptare portuale aplikojnë *online* në sistemin *e-visa.al*,

b) përgjegjësi i turnit verifikon dokumentacionin, vendos vizën pullë në dokumentin e udhëtimit ose gjeneron vizën elektronike, si dhe bën shënimet në regjistrin elektronik për të huajt (REH), njofton PKK-në përkatëse ku do të bëhet imbarkimi apo riimbarkimi i të huajt anëtar të ekuipazhit të lundrimit të pajisur me vizë dhe pasqyron informacionin mbi vizën e dhënë në komunikatën ditore;

c) PKK-ja në të cilën bëhet imbarkimi apo riimbarkimi, në momentin e imbarkimit apo riimbarkimit bën regjistrimin në dalje të anëtarit të mjetit të lundrimit dhe njofton PKK-në që ka lëshuar vizën për veprimet e kryera;

ç) në rast mos njoftimi të PKK-së lëshuese të vizës, brenda afatit të vlefshmërisë së vizës nga PKK-ja ku do të bëhet imbarkimi apo riimbarkimi, autoriteti i PKK-së lëshues i vizës njofton nëpërmjet autoritetit vendor të kufirit dhe migracionit, autoritetin vendor të kufirit dhe migracionit në të cilin ndodhet PKK-ja ku do të bëhet imbarkimi apo riimbarkimi i anëtarit të mjetit të lundrimit, për të vijuar me procedurat e parashikuara ndaj shtetasit të huaj dhe agjencisë portuale, e cila ka bërë garancinë për shtetasin e huaj, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar;

d) dokumentacioni përkatës për lëshimin e vizës ruhet në PKK për një afat 1-vjeçar. Autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin, dërgon informacion mbi vizën e dhënë SHISH-it, deri në përfundimin e përmirësimeve në modulën *e-Visa* për regjistrimin e vizave të lëshuara në kufi.

3. Në rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë tranzit, sipas procedurave të përshkruara në pikën 2, të kreut VI, të këtij udhëzimi, anëtarët e huaj të mjetit të lundrimit, që duhet të kthehen në vendin e origjinës pas përfundimit të kontratës apo në rastet e ndryshimit të ekuipazhit të mjeteve lundruese.

4. Përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë të huajin për rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, duke proceduar si vijon:

a) plotëson një raport shërbimi mbi situatën emergjente të krijuar dhe kur është e mundur i bashkëlidh këtij raporti dokumente shtesë, nga institucione shtetërore ose jo, të përfshira në situata emergjente;

b) kërkon miratim me shkrim për lëshimin e vizës nga autoriteti vendor i kufirit dhe migracionit, pas konsultimit dhe aprovimit verbal nga DKM-ja;

c) pas miratimit nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, përgjegjësi i turnit vendos vizën pullë në dokumentin e udhëtimit të të huajt, bën shënimet e nevojshme në REH, si dhe pasqyron informacionin në komunikatën ditore;

ç) dokumentacioni përkatës për lëshimin e vizës ruhet në PKK për një afat 1-vjeçar.



5. Përgjegjësi i turnit në PKK pajis me vizë të huajin për rastet e parashikuara në nenin 25, pika 2, shkronja “b”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, duke proceduar, si më poshtë:

a) kontrollon dokumentet spitalore ose të autoriteteve të tjera shtetërore përgjegjëse për lëshimin e tyre që vërtetojnë rastin e vdekjes ose të sëmundjes së rëndë, si dhe lidhjen me kërkuesin e vizës;

b) plotëson një raport shërbimi mbi rastin konkret;

c) kërkon miratim me shkrim për lëshimin e vizës nga autoriteti vendor i kufirit dhe migracionit, pas konsultimit dhe aprovimit verbal nga DKM-ja;

ç) pas miratimit nga autoriteti vendor për kufirin dhe migracionin, përgjegjësi i turnit vendos vizën pullë në dokumentin e udhëtimit të të huajt, bën shënimet e nevojshme në REH, si dhe pasqyron informacionin në komunikatën ditore;

d) dokumentacioni përkatës për lëshimin e vizës ruhet në PKK për një afat 1-vjeçar.

VII. PROCEDURA E REFUZIMIT TË VIZËS

1. Në të gjitha rastet e refuzimit të vizës, të parashikuara në nenin 28, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, vendimi për refuzim i përcillet DÇK-së, e cila ja komunikon atë, së bashku me arsyen e refuzimit, MDPK-së, nëpërmjet sistemit *e-Visa*.

2. Konsulli njofton të huajin për refuzimin e vizës dhe i komunikon aktin administrativ, nëpërmjet sistemit *e-visa.al* ose nëpërmjet formatit i cili gjenerohet nga sistemi dhe i shkon aplikuesit në postën elektronike, sipas formatit në aneksin nr. 2.

3. Në asnjë rast Konsulli nuk jep informacion mbi institucionet apo autoritetin që ka dhënë mendim për refuzimin e vizës.

4. I huaji, pritësi, institucioni ftues ose personi i autorizuar me prokurë të posaçme kanë të drejtë që **brenda 5 ditëve pune**, të paraqesin kërkesën për apelim në DÇK. DÇK-ja, **brenda 5 ditëve pune**, merr vendim dhe njofton të huajin, pritësin ose garantuesin. Në rast të vlerësimit negativ të apelimit, shtetasi ka të drejtë të riaplikojë vetëm pas 3 muajsh nga data e fundit e refuzimit. Apeli për refuzimin e vizave “A” dhe “C” kryhet edhe nëpërmjet llogarisë personale të

shtetasit të huaj në sistemin *e-visa.al* ose në postën elektronike të dedikuar të DÇK-së visa@mfa.gov.al, ndërsa apeli për refuzimin e vizave “D”, kryhet vetëm në postën elektronike të DÇK-së, visa@mfa.gov.al.

VIII. PROCEDURA E ANULIMIT TË VIZËS

1. Për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 27, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, vendimi i anulimit të vizave merret nga MDPK-ja ose DÇK-ja, kur viza është lëshuar nga këto autoritete dhe nga DKM-ja kur viza është lëshuar në kufi.

2. Me miratimin e DÇK-së, konsulli në MDPK vlerëson pavlefshmërinë e vizës dhe anulon vizën elektronike/pullë nëpërmjet sistemit *e-visa.al* ose i komunikon të huajt vendimin për anulim nëpërmjet aktit administrativ të gjeneruar nga sistemi, i cili i dërgohet aplikuesit në postën elektronike. Akti administrativ, sipas formatit të përcaktuar në aneksin nr. 2, së bashku me vendimin dhe arsyen e anulimit të vizës, i përcillet Misionit Diplomatik ose Postit Konsullor, DÇK-së, në postën elektronike visa@mfa.gov.al, si dhe DKM-së në adresën policiakufitare@asp.gov.al. Anulimi i vizës evidentohet në sistemin *e-Visa* dhe TIMS, përpara hyrjes së të huajt në territorin e Republikës së Shqipëri. I huaji, pritësi, institucioni ftues ose personi i autorizuar me prokurë të posaçme të noterizuar, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për apelim pranë DÇK-së **brenda 5 (pesë) ditëve pune** nga data e njoftimit të vendimit për anulim. DÇK-ja, brenda 5 ditëve pune, merr vendim dhe njofton të huajin, pritësin ose garantuesin. Në rast të vlerësimit negativ të apelimit, shtetasi ka të drejtë të riaplikojë vetëm pas kalimit të 3 (tre) muajve nga data e fundit e refuzimit.

3. Kur i huaji ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, vendimi për anulimin e vizës i marrë nga MDPK-ja ose DÇK-ja i përcillet DKM-së për zbatim. Informacioni për bërjen të pavlefshme të vizës pasqyrohet në sistemin *e-Visa* dhe TIMS.

4. Autoriteti përgjegjës për kufirin dhe migracionin, në rast konstatimi, gjatë kontrollit në territor, njofton të huajin për të cilin është marrë vendimi i anulimit të vizës, bën anulimin e vizës në pasaportën e të huajt sipas nenit 27, pika 2, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt” dhe informon



MEPJ-në për zbatimin e kërkesës për anulimin e vizës.

5. Në rastet e anulimit të vizës sipas nenit 27, pika 1, shkronjat “b” dhe “ç”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, DKM-ja i përcjell kërkesën MEPJ-së për anulimin e vizës së të huajt dhe merr masa për largimin e tij nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.

6. Në rast se autoritetet e përfshira në procedurën e lëshimit të vizës në DKM dhe SHISH konstatojnë një nga rastet për të cilat bëhet anulimi i vizës, i kërkojnë MEPJ-së anulimin e vizës për të cilën më parë kanë dhënë mendim pozitiv.

7. Në rast se kërkesa për anulimin e vizës bëhet nga autoritetet doganore apo kufitare, sipas nenit 28, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, të ndryshuar, kërkesa drejtuar MEPJ-së për anulimin e vizës duhet të shoqërohet me argumente dhe prova që vërtetojnë shkeljet nga ana e të huajt.

8. I huaji, nga momenti i marrjes së njoftimit, ka të drejtën të apelojë pranë strukturës së DÇK-së, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative, e cila merr në shqyrtim kërkesën dhe njofton me shkrim të huajin për vendimin e marrë, sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative. Me dhënien e vendimit, procedura konsiderohet e përfunduar dhe kryhet njoftimi i strukturave të MDPK-së dhe DKM-së. Korrespondenca mund të kryhet edhe përmes zyrës postare ose postës elektronike.

9. Pas njoftimit për anulimin e vizës i huaji nuk ka të drejtë të hyjë në territorin e RSH-së. Nëse gjendet në territorin e RSH-së, me përfundimin e procedurës së apelimit, i huaji duhet të largohet nga Shqipëria.

IX. ADMINISTRIMI I VIZAVE PULLË

1. DÇK-ja është autoriteti përgjegjës për menaxhimin dhe evidentimin e vizave pullë. DÇK-ja planifikon shpërndarjen e vizave pullë për MDPK-në, sipas kërkesave të këtyre të fundit.

2. Në rast humbjeje, DÇK-ja njofton shtetet e huaja për seritë e pullave të humbura.

3. Në rast dëmtimi ose plotësimi të gabuar, konsulli në MDPK evidenton numrin e vizës pullë me procesverbal, i cili arkivohet së bashku me vizën pullë të nxjerrë jashtë qarkullimit. Jo më pak

se 2 (dy) herë në vit vizat pullë të nxjerra jashtë qarkullimit dërgohen në DÇK për asgjësim.

4. Asgjësimi i vizave pullë të nxjerra jashtë qarkullimit bëhet të paktën 1 (një) herë në vit me komision të përbërë nga 3 (tri) veta, specialisti përgjegjës për vizat në Drejtorinë e Çështjeve Konsullore, Përgjegjësi i Sektorit Konsullor dhe drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Konsullore. Në fund të asgjësimit mbahet procesverbal dhe të dhënat për vizat pullë të asgjësuara i vihen në dispozicion DKM-së.

5. MDPK-ja dhe PKK-ja regjistrojnë vizat pullë të marra dhe i administrojnë ato sipas kriterëve të veçanta të administrimit të letrave me vlerë. MDPK-ja dhe PKK-ja nxjerrin në përdorim vizat pullë sipas numrit rendor përkatës.

X. PROCEDURA E PËRLLOGARITJES SË AFATEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT QË HYJNË NË TERRITOR PA VIZË

1. Strukturat përgjegjëse të kufirit dhe migracionit, gjatë kontrollit të të huajve në hyrje, qëndrim dhe dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë, përllogarisin afatet e qëndrimit dhe verifikojnë respektimin e kriterit të qëndrimit 90 (nëntëdhjetë) ditë për 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, ose 1 (një) vit për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe afatet e përcaktuara në vizë ose në leje qëndrimi, mbi bazën e së cilës i huaji kërkon të hyjë ose ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, merren në konsideratë afatet e parashikuara në marrëveshje qeveritare ose në vendime të Këshillit të Ministrave për qëndrim të njëanshëm.

2. Në hyrje të RSH-së përllogaritja e afatit të qëndrimit në territor, 90 ditë brenda 180 ditëve, bëhet referuar ditës së hyrjes duke numëruar mbrapa në kohë 180 ditë.

3. Nëse gjatë kontrollit në territor ose gjatë kontrollit në Pikën e Kalimit Kufitar, gjatë daljes së të huajt nga territori, konstatohet se i huaji ka qëndruar më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve të fundit ose ka tejkaluar afatet e largimit të përcaktuar në një urdhër largimi/dëbimi, atëherë ai konsiderohet i huaj me qëndrim të parregullt në territor. Qëndrimi mbi afatin e sipërpërmendur mundësohet vetëm për të huajt që:

- a) janë të pajisur me leje qëndrimi/unike;
- b) posedojnë aktin e zgjatjes së afatit të qëndrimit;
- c) kanë marrëveshje qeveritare;



ç) kanë qëndrimin të njëanshëm, të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) janë shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës që qëndrojnë deri në 1 (një) vit.

4. Dita e hyrjes dhe dita e daljes së të huajit llogariten secila nga 1 (një) ditë qëndrimi. Nëse i huaji hyn dhe del brenda një dite, atëherë llogaritet 1 (një) ditë qëndrimi.

5. Për të huajt që hyjnë pa vizë, por për të aplikuar për leje qëndrimi/unike duhet të pajisen me vizë sipas motivit të kërkuar të qëndrimit, numërimi i ditëve të qëndrimit përlllogaritet sipas hyrjes me vizë tipi “D” dhe afatit të përcaktuar në të.

6. Për shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, llogaritja e afateve të qëndrimit kryhet mbi bazën e qëndrimit të tyre jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për 90 (nëntëdhjetë) ditë ose mbi bazën e një periudhe qëndrimi deri në 1 (një) vit, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja e afateve bëhet duke iu referuar ditës në të cilën kryhet kontrolli ndaj shtetasit të huaj dhe duke numëruar mbrapa në kohë një periudhë 1-vjeçare (njëvjeçare).

XI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi i përbashkët midis ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrit të Brendshëm dhe Shërbimit Informativ të Shtetit nr. 242, datë 20.12.2022, “Mbi bashkëpunimin e strukturave të ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ të Shtetit për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”, shfuqizohet.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME

Besfort Lamallari

MINISTËR PËR EVROPËN

DHE PUNËT E JASHTME

Ferit Hoxha

DREJTOR I SHËRBIMIT
INFORMATIV TË SHTETIT

Vlora Hyseni



Aneksi 1

REQUEST FOR TRANSFERRING A VISA APPLICATION

(Kërkesë transferim të aplikimit për vizë)

According to DCM 858/2021, Ch. II, A, Art. 6

(Bazuar në VKM 858/2021, Kreu II, A, pika 6)

I. Information on visa applicant (Të dhëna për aplikantin)

1. First Name:.....
2. (Emër).....
3. Surname:.....
- (Mbiemër).....
- Nationality:.....

4. (Shtetësia) Date of Birth:..... / / (dd/mm/yyyy)
- Konsullore (Datëlindja dd/mm/vvvv)
5. Place of Birth:.....
- (Vendlindja)
6. Passport number:.....
- (Numri i pasaportës)
7. Passport expiry date:..... / / (dd/mm/yyyy)
- (Vlefshmëria e pasaportës)

II. Information on person applying for the transfer (transfer applicant) (Të dhëna për personit që kërkon transferimin)

1. First Name:.....
- (Emër)
2. Surname:.....
- (Mbiemër)
3. Nationality:.....
- (Shtetësia)
4. Date of Birth:..... / / (dd/mm/yyyy)
- (Datëlindja dd/mm/vvvv)
5. Passport / ID number:.....
- (Numri i pasaportës ose ID)
6. Relation to visa applicant: ☐ Visa applicant: Guarantor of visa ☐ applicant:
(Raporti me aplikantin për vizë) (Aplikanti për vizë) (Garantuesi i) (Aplikantit për vizë)
7. Address of transfer applicant:.....
- (Adresa e aplikantit)
8. Telephone:
- (Telefon)
9. Mobile phone:.....
- (Telefon mobile)
10. E-mail:.....
- (Email)

III. Information on visa and purpose of request (Të dhëna për kërkesën për vizë dhe qëllimin e transferimit)

1. Emb./Consulate to apply at:.....
- (Përfaqësia ku kërkohet aplikimi)
2. Type of visa:..... ☐ Transit visa: C-Type ☐ visa: D-Type visa: ☐
(Lloji i vizës) (Vizë transite) (Vizë tipi C) (Vizë tipi D)
3. Purpose of transfer request:.....
- (Motivet e kërkesës për transferim)

Signature of the transfer applicant:
(Nënshkrimi)

Place (Vendi)

Date (data)

Remarks by the authorities / Only for official notes (Shënimet e autoritetit shqyrtues)			
Shqyrtuar:	 / /	Rishqyrtuar:	 / /
Shënim:		Shënim:	
			
			

Transfer Application Form V31
(Formular aplikimi për transferimin)



Aneksi nr. 2

STANDARD FORM NOTIFYING AND MOTIVATING REFUSAL/ANNULMENT
(Forma standard e njoftimit dhe motivimit të refuzimit/ anulimit)

REFUSAL/ANNULMENT OF VISA
(Refuzimi/Anulimi i vizës)



REPUBLIC OF ALBANIA
Republika e Shqipërisë

Ms./Mrs./Mr.: _____

(Z./Zg./Zgësh.)

☐ The Albanian Embassy/General Consulate/Other Competent Authority: _____

(Anbasada/Konsullata e Përgjithshme/Konsullatat/Autoritetet tjetër kompetent);

Has/have: (ka/karë:)

☐ examined your visa application with the code number;

(shqyrtoar aplikimin tuaj për vizë me kod numër);

☐ examined your visa, number: _____ issued: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)

(shqyrtoar vizën me numër);

(teshtuar më datë)

☐ The visa has been refused

(viza është refuzuar);

☐ The visa has been annulled;

(viza është anuluar);

This decision is based on the following reason(s):

(Ky vendim është i bazuar në arsyen (të) e mëposhtme)

1. ☐ was presented a false/counterfeit document;
(është paraqitur një dokument i falsifikuar/i parregullt udhëtimi);
2. ☐ justification for the purpose and conditions of the intended stay was not provided;
(nuk justifikohet qëllimi dhe kushtet e qëndrimit);
3. ☐ you have not provided proof of sufficient means of subsistence, for the duration of the intended stay or for the return to the country of origin or residence, or for the transit to a third country into which you are certain to be admitted;
(nuk dëshmohet se aktërori mjete të mjaftueshme jetese për kohëgjatësinë e qëndrimit ose për rikthimin në vendin e origjinës/vendbanimit ose për transituar në një vend të tretë, për të cilin nuk kanë garanci se do të pranohet);
4. ☐ you have already stayed for three months during the current six-month period on the territory of Republic of Albania.
(kemi tejkaluar afatit tre muaj për gjatësi muaj qëndrimi në territorin e Republikës së Shqipërisë);
5. ☐ proof of holding an adequate and valid travel medical insurance was not provided;
(nuk kanë dëshmuar se zotëronin sigurancën mjekësor të përshtatshëm dhe/apo të vlefshëm);
6. ☐ the information submitted regarding the justification for the purpose and conditions of the intended stay was not reliable;
(informacioni i paraqitur lidhur me motivin e kërkesës dhe të kushteve të qëndrimit të dhënë nuk është i besueshëm);
7. ☐ your intention to leave the territory of the Republic of Albania before the expiry of the visa could not be ascertained;
(nuk garantohej detyrimi juaj për të lënë territorin e Republikës së Shqipërisë para skadencës së vizës);
8. ☐ sufficient proof that you have not been in a position to apply for a visa in advance, justifying application for a visa at the border, was not provided;
(nuk kanë dëshmuar mjaftueshëm se për shkak të pamundësisë reale për të aplikuar për vizë ju lejohet të aplikoni për vizë në kufi);
9. ☐ other legal reasons: _____;
(arsye të tjera ligjore);

Date and stamp of Embassy/Consulate-General/Consulate/the other Authorities responsible for the checks on persons:

(data dhe vulat e Ambasadës/Konsullatës së Përgjithshme/Konsullatës/ Autoriteteve të tjera për verifikimin e të huajve);

_____/_____/____ (dd/mm/yyyy)

Signature of the Consul

(Nënshkrimi i Konsullit)

REMARKS/(VËREJTJE):

Within 5 working days as from receiving this notification, the person concerned may appeal against the decision to refuse/annul a visa as provided for in national Law 79/2021 "On Foreigners". (Brenda 5 ditë pune prej marrjes së këtij njoftimi, i huaji i interesuar ka të drejtë të apelojë kundër vendimit të refuzimit/anullimit të vizës siç parashikohet nga ligji 79/2021 "Për të huajt". Autoriteti përgjegjës është): The authority responsible is:

The person concerned must receive a copy of this document/(Personi i interesuar duhet të pajiset me një kopje të këtij dokumenti).



Aneksi nr. 2

Ministry for Europe and Foreign Affairs of Republic of Albania/Directorate for Consular Issues

Adress: Boulevard “Gjergj Fishta” No. 6; 1000 Tirana; **Tel:** 00355 -423 64 090 ext. 157; **Email:** visa@mfa.gov.al

The person concerned must receive a copy of this document/ *(Personi i interesuar duhet të pajiset me një kopje të këtij dokumenti).*



Aneksi nr. 3

BORDER VISA FORM

(Formular Viza kufiri)

According to Law 79/2021 "On Foreigners" Art.25 Paragraph d

(Bazuar në Ligjin 79/2021 " Për të Huajt " Nen. 25 pika d)



REPUBLIC OF ALBANIA

Republika e Shqipërisë

MINISTRY FOR EUROPE AND

FOREIGN AFFAIRS

Ministria për Evropën dhe Punët e

Jashtme

I. Information on visa applicant (Të dhëna për aplikantin)

1. Surname: _____
(Mbiemër)
2. Full Name: _____
(Emër)
3. Place of Birth: _____
(Vendlindja)
4. Date of birth: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(Datëlindja dd/mm/vvvv)
5. Nationality: _____
(Shtetësia)
6. Passport number : _____
(Numri i pasaportës)
7. Passport Type: _____
(Tipi i pasaportës)
8. Passport Issuing Date: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(data e lëshimit të pasaportës)
9. Passport Date of Expiry: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(Vlefshmëria e pasaportës)
10. Date of Arrival in Albania: ____/____/____ (dd/mm/yyyy)
(Data e hyrjes në Shqipëri)
11. Entry Border Point in Albania: _____
(Pika kufitare e hyrjes në Shqipëri)
12. Duration of Stay: _____
(kohëzgjatja e qëndrimit)
13. Purpose of traveling: _____
(Motivi i udhëtimit)

Address/Adresa:

Directorate for Consular Issues
Drejtoria për Çështjet KonsulloreBulevardi Gjergj Fishta 6
1000 Tirana;

Tel.: 00355-4- 23 64 090 ext. 157

Mobile: 0693766600

Email: DK@mfa.gov.al;visa@mfa.gov.al

Signature of the applicant:

(Nënshkrimi i kërkuar)

Place (Vendi)

Date (data)

Only for official remarks. Please do not write here.

(Vetëm për shënime zyrtare)


Marrja:
Shqyrtimi:

ANEKS 4

INFORMATION ABOUT THE SQsign APPLICATION

SQsign App is the only authorised application to enable the verification of the e-Visa issued by the Republic of Albania with a QR Code.


THE APPLICATION CAN BE DOWNLOADED VIA THE:

App Store (iOS)**Play Store (Android)**



STEPS TO VERIFY AN ELECTRONIC VISA VIA THE SQSIGN APP

After opening the Application you have the option to choose the Albanian or English language version by choosing from the top-right hand corner.



NËSE VISA ËSHTË E VLEFSHME IF THE E-VISA IS VALID



Open document

Emri Mbiemër /
Name Surname: Mihalj Aleksandr
Tipi i vizës / Visa Type: C
Nr. Serial / Serial No.: AL0022155e



Statusi: **Valid**

Digital stamp verification

NËSE VISA NUK ËSHTË E VLEFSHME IF THE VISA IS NOT VALID




Statusi: **Not Valid**

Digital stamp verification

LINK PËR VERIFIKIMIN E VIZËS ELEKTRONIKE SHQIPTARE/
LINK FOR THE VERIFICATION OF THE ALBANIAN ELECTRONIC VISA:

<https://e-visa.al/verify>

1. Përzgjedhim rubrikën verifiko/ [We choose Verify](#)



2. Vendosim numrin e vizës dhe numrin e pasaportës për të verifikuar vizën/ [To verify the electronic visa we enter the visa number and the passport number](#)

Verify visa

Visa Number

Passport Number

Verify

Electronic VISA REPUBLIC OF ALBANIA				AI [REDACTED]	
E VLEFSHME PER VALID FOR VALABLE POUR		Albania			
NGA FROM DU		14-04-2025		DERI UNTIL AU	
				13-10-2025	
TIPI VIZES TYPE OF VISA		D		AFATI I QENDRIMIT DURATION OF STAY	
TYPE DE VISA		NUMRI I HYRJEVE NUMBER OF ENTRIES		DITE DAYS	
		MULT D'ENTREES		OF 90 JOURS	
LESHUAR NE ISSUED IN DELIVRE A		ABU DHABI			
ME ON LE		14-04-2025		NUMRI I PASAPORTES NUMBER OF PASSPORT	
				NUMERO DE PASSEPORT	
MBTEMER, EMER SURNAME, NAME NOM, PRENOM		[REDACTED]			
SHENIME REMARKS REMARQUES		VISA D/PN-15			

3. Faza finale është konfirmimi i statusit të vizës/ The final step is the confirmation of the *e-visa* status: Approved and printed/generated

Visa Number

2134e

Passport Number

9827

Verify

Visa status: Approved and
printed/generated

OK



URDHËR

Nr. 88, datë 8.5.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; si dhe të VKM-së nr. 395, datë 13.5.2020, “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, drejtorit të Drejtorisë së Negocimit dhe Asistencës Ligjore, znj. Denada Dosti.

2. Kompetencat e titullarit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin do të ushtrohen për periudhën nga data 11.5.2026 deri në datën 12.5.2026.

3. Nuk delegohen kompetenca të padelegueshme, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet znj. Denada Dosti, drejtor i Drejtorisë së Negocimit dhe Asistencës Ligjore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

URDHËR

Nr. 122, datë 29.4.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË
INTEGRITETIT TË MINISTRISË
SË ARSIMIT 2026–2029

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 16, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 859, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030, planit të veprimtimit 2026–2029, në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës”, dhe vendimit nr. 514, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Arsimit (MA) 2026–2029, në zbatim të masave të planifikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Grupi i Punës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi



PLANI I INTEGRITETIT PËR MINISTRINË E ARSIMIT 2026–2029

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Plani i Integritetit – Shtyllë për transparencë, llogaridhënie dhe qeverisje me parime etike në Ministrinë e Arsimit

Hartimi dhe zbatimi i politikave arsimore përbën boshtin strategjik mbi të cilin ndërtohet e ardhmja e vendit. Integriteti institucional në këtë proces është jetik për të garantuar që çdo vendimmarrje, ligj apo reformë të jetë produkt i një administrimi të ndershëm, larg interesave të ngushtë dhe në shërbim të plotë të interesit publik.

Korrupsioni dhe cenimi i etikës në nivel administrativ përbën një rrezik real, pasi deformon parimet e meritokracisë. Për këtë arsye, udhëheqja e politikave arsimore kërkon një qasje të vendosur dhe të mbështetur në parime të forta të integritetit institucional. Parimet tona – ndershmëria, transparenca, llogaridhënia, përgjegjshmëria, paanshmëria në proceset vendimmarrëse dhe respekti për ligjin – përbëjnë themelin mbi të cilin është ndërtuar Plani i Integritetit i Ministrisë së Arsimit.

Ky dokument strategjik është një instrument pune, i hartuar për të garantuar një administratë qendrore të pastër dhe me përgjegjësi të lartë në hartimin e politikave publike. Plani është rezultat i një procesi të mirëstrukturuar, ku qëllimi kryesor është identifikimi i zonave me rrezik të lartë – si prokurimet publike, hartimi i akteve rregullatore dhe menaxhimi i burimeve strategjike – për të ndërmarrë masa konkrete parandaluese, në përputhje me standardet më të larta të etikës profesionale.

Në këtë proces, angazhimi individual i çdo punonjësi të administratës së Ministrisë është vendimtar. Sjellja profesionale dhe etike e individëve në funksione publike, veçanërisht në hallkat ku hartohen dhe miratohen politikat arsimore, është themeli mbi të cilin ndërtohet besimi dhe integriteti i të gjithë sistemit tonë institucional.

Ndërtimi i një kulture institucionale që promovon ndershmërinë, përgjegjshmërinë dhe sinjalizimin e praktikave të gabuara është thelbësor për një qeverisje që shërben me dinjitet. Gjithashtu, respektimi i parimeve të gjithëpërfshirjes dhe barazisë siguron që çdo vendimmarrje strategjike të marrë në konsideratë zërin e të gjithë aktorëve, duke

garantuar drejtësi dhe eliminimin e çdo forme të favorizimit.

Me miratimin dhe zbatimin e këtij plani, Ministria e Arsimit, jo vetëm përforcon strukturat e saj të brendshme, por udhëheq në mënyrë rigoroze procesin e hartimit të politikave në arsim, duke e vendosur integritetin si standardin bazë të të gjithë sistemit institucional.

Mirela Kumbaro Furxhi
MINISTËR I ARSIMIT

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESA DHE AKRONIME

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzor

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi rreziqeve të integritetit

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi i tij

Faza 4: Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i Planit

Metodologjia

2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit

2.1 Objektivi Strategjik I: Forcimi i etikës dhe integritetit publik

2.2 Objektivi Strategjik II: Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

2.3 Objektivi Strategjik III: Përmirësimi i transparencës së ministrisë

2.4 Përmirësimi i drejtëmeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në fushën e arsimit

3. Zbatimi i Planit të Integritetit: Monitorimi dhe raportimi

Objektivi I: Forcimi i etikës dhe integritetit publik në Ministrinë e Arsimit

Objektivi II: Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore

Objektivi III: Përmirësimi i transparencës së Ministrisë së Arsimit

Objektivi IV: Përmirësimi i drejtëmeve dhe ndërhyrjeve të politikave për të promovuar integritetin dhe parandaluar korrupsionin në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor



SHKURTESA DHE AKRONIME

AB	Auditimi i Brendshëm
DPAL	Drejtoria e Programeve të Arsimit të Lartë
DPZHKSH	Drejtoria e Politikave për Zhvillimin e Kërkimit Shkencor
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
APU	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
DAB	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DBNJ	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
GPI	Grupit të i Punës për Integritetin
IAL	Institucionet e arsimit të lartë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave
KI	Konflikti i interesit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
LAL	Ligji “Për arsimin e lartë”
MA	Ministria e Arsimit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
PBA	Plani buxhetor afatmesëm
PI	Plani i Integritetit
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PSV	Procedura standarde të veprimi
SKA	Strategjia Kombëtare për Arsimin
SKKSHTI	Strategjia Kombëtare e Kërkimit Shkencor Teknologjisë dhe Inovacionit 2023–2030
TIK	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
VNR	Vlerësimi i ndikimit rregullator

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Korrupsioni në arsim dhe mungesa e integritetit kanë një ndikim negativ në shoqëri. Ato dëmtojnë cilësinë, efektivitetin dhe besueshmërinë e arsimit, efikasitetin e ofrimit dhe barazinë e mundësive për rininë që është pasuria më e madhe e çdo vendi dhe begatia e tij sociale, kulturore, shkencore dhe ekonomike. Lufta kundër korrupsionit është me rëndësi vendimtare për zhvillimin e një vendi modern demokratik dhe për zbatimin e parimeve të shtetit ligjor dhe qeverisjes së mirë. Kësisoj, duke zbatuar masat për uljen e korrupsionit, ndikimi në shoqëri do të reflektohet me zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe në rritjen e investimeve, duke çuar përpara Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri. Po ashtu, lufta kundër korrupsionit rrit besimin e publikut tek institucionet publike dhe nxit angazhimin e aktorëve kryesorë në procesin e vendimmarrjes.

Qëllimi kryesor i Ministrisë së Arsimit (MA) është të sigurojë arsim cilësor për çdo qytetar pavarësisht moshës apo statusit socioekonomik të tij/saj. Për këtë arsye, ministria është e angazhuar në zhvillimin e politikave që përmirësojnë integritetin

institucional dhe konkretisht hartimin e një Planit Integriteti (PI), që është një dokument antikorrupsioni për institucionin. Ky plan ka për qëllim konsolidimin e sistemit të menaxhimit të integritetit dhe përmirësimin e standardeve të etikës nëpërmjet forcimit të kuadrit të brendshëm rregullator, si dhe zhvillimit të mjeteve që nxisin transparencën dhe llogaridhënien e ministrisë. Plani ka një qasje ndërsektoriale për të luftuar korrupsionin dhe sjelljen joetike në institucion, me qëllim arritjen e objektivit. Plani si dokument antikorrupsion përmban një sërë masash që parandalojnë, apo eliminojnë mundësitë për shfaqjen dhe zhvillimin e formave të ndryshme të sjelljeve korruptive dhe joprofesionale brenda institucionit. Plani u hartua pas vlerësimit të nivelit të ekspozimit të pozicioneve dhe/apo funksioneve të caktuara dhe proceseve të punës ndaj shfaqjes dhe zhvillimit të rreziqeve të korrupsionit dhe formave të tjera të sjelljes joetike apo joprofesionale të punonjësve.

Ky plan u hartua me përfshirjen e punonjësve të institucionit dhe u mbështet në analizimin e plotë të informacionit. Në veçanti, u krye një analizë



gjithëpërfshirëse e situatës për të identifikuar sfidat kryesore me të cilat përballet ministria për sa u përket transparencës dhe llogaridhënies. Procesi i vlerësimit të riskut të integritetit në ministri u realizua gjatë periudhës mars–prill 2026. Në këtë vlerësim u përfshinë të gjitha funksionet e punës dhe proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë të ministrisë, përkatësisht: i. fusha e menaxhimit financiar; ii. fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore; iii. fusha e kontrollit dhe e auditimit; iv. fusha e transparencës; v. fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve shkresore, si dhe informacionit e të dokumenteve elektronike; vi. fusha rregullatore dhe e përputhshmërisë për çështjet e arsimit; vii. fusha e lejeve, licencave në arsim dhe monitorimit të shërbimeve; viii. fusha e politikave dhe e strategjive në fushën e arsimit; ix. fusha e jetësimit të prioritetëve dhe e statistikave në sektorin e arsimit. Drejtimit, synimet dhe objektivat kryesorë të Planit të Integritetit u përcaktuan në bazë të mangësive dhe sfidave që u identifikuan në sistem si rezultat i analizës. Fazat nëpër të cilat ka kaluar ky proces në ministri, sipas Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, janë si më poshtë:

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Për hartimin e Planit të Integritetit u ngrit një grup pune me urdhrin e ministrit të Arsimit nr. 64, datë 6.3.2026, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Planit të Integritetit 2026–2029”. Në përbërje të grupit të punës ishin 13 anëtarë dhe 1 koordinator i grupit të punës. Në punën e tij, ky grup mbështetet nga një sekretariat teknik me 3 punonjës të ministrisë. Grupi i punës kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, i cili komunikoi qëllimin dhe objektivat e Planit të Integritetit me punonjësit e aparatit të ministrisë në një takim informues¹ për Planin e Integritetit dhe procesin e hartimit të tij. Ky takim, i mbajtur që në fillim të procesit të hartimit të Planit të Integritetit, i shërbeu grupit të punës për shqyrtimin dhe zhvillimin e analizës së vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimin e Planit të Integritetit.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit

Gjatë kësaj faze, Grupi i Punës shqyrtoi kuadrin ligjor, rregullator dhe strategjik të ministrisë, raportet

e monitorimit të strategjive, dokumente të ndryshme pune të ministrisë, si dhe analiza të sektorit të arsimit. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion.

Grupi i Punës vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së ministrisë. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të mbledhura nga diskutimet në fokus grupe me punonjësit e drejtorive të ministrisë. Këto diskutime shërbyen për të parashtruar ide, për konsultime dhe debate në identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit, veçanërisht në rastet kur ekzistojnë masa paraprake kontrolli dhe parandalimi.

Në këtë fazë të procesit, Grupi i Punës hartoi pyetësorin për punonjësit e ministrisë për vetëvlerësimin e integritetit brenda institucionit. Pyetësori u plotësua në mënyrë anonime, në formë elektronike, për të siguruar të dhëna dhe informacione të besueshme për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi i tij

Nga analiza e kuadrit rregullator dhe të politikave të ministrisë për menaxhimin e riskut të integritetit në ministri, si dhe nga analiza e fazave të mësipërme rezultoi se Ministria e Arsimit kishte hartuar dhe vënë në zbatim rregulla, dokumente politikash, instrumente, praktika dhe masa kontrolli për parandalimin apo eliminimin e risqeve të korrupsionit. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tyre. Disa nga masat e parashikuara në këtë plan janë: hartimi i një Kodi Etike për punonjësit e ministrisë dhe stafin me funksione politike, krijimi i instrumenteve për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, një grup rekomandimesh për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe të politikave, përfshirë edhe realizimin e trajnimeve, organizimin e seminareve, takimeve, aktiviteteve ndërgjegjësuere për punonjësit e ministrisë në të gjitha nivelet e drejtimit.

¹ Takimi u realizua më datë 25.3.2026.

**Faza 4: Monitorimi, raportimi dhe rishikimi i Planit**

Monitorimi është periodik (raporte 6-mujore dhe vjetore) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës, për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë eficiente, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të institucionit, apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (planit të veprimit), si edhe nxjerrjen e mësimave për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Koordinator i Integritetit, i mbështetur nga Sekretariati Teknik, ka tagrin të kërkojë informacion zyrtar nga të gjitha drejtoritë e listuara më poshtë, për të garantuar mbarëvajtjen e planit.

Raporti i monitorimit, pasi miratohet nga titullari i institucionit, bëhet publik dhe është lehtësisht i aksesueshëm në faqen e internetit të institucionit. Raporti i lejon titullarit të ndërmarrë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e këtij plani janë:

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria e Arsimit Cilësor dhe Gjithëpërfshirës

Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Programeve të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor

Drejtoria e Programeve të Arsimit të Lartë

Drejtoria e Politikave për Zhvillimin e Kërkimit Shkencor

Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin

Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Drejtoria e Integritetit, Marrëveshjeve dhe Projekteve

Drejtoria e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit të Shërbimeve

Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave**Drejtoria e Auditimit të Brendshëm**

Mbledhja e informacionit nga këto drejtori do të kryhet nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila drejtori do të raportojë mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashikuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumente të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; rekomandime dhe konkluzione. Draftraporti i hartuar do të konsultohet me të gjitha drejtoritë raportuese dhe pas miratimit nga ministri i Arsimit raport monitorimi do të publikohet në faqen web të Ministrisë së Arsimit.

Metodologjia

Për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në institucionin e Ministrisë së Arsimit u përdorën dy metoda, në zbatim të dokumentit bazë, të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore.

1. Metoda cilësore: përmes analizimit dhe marrjes në konsideratë të informacioneve të dhëna në raportet e monitorimit 6-mujore dhe vjetore të Planit të Integritetit 2022–2025, raportimet mujore të Kartës së Performancës së ministrisë, veprimtaria dhe aktivitetet publike. Po ashtu, u analizuan raporte të ndryshme dhënë institucionit, si: raportet për përgatitjen e planit vjetor dhe planeve strategjike të njësisë së auditimit të brendshëm, plani i auditimeve për vitin 2026, si dhe plani strategjik i veprimtarisë së DAB-së për periudhën 2026–2028. Raporte të tjera për veprimtarinë e ministrisë të hartuara nga institucione kombëtare, ndërkombëtare apo organizata të ndryshme. Procesi u shoqërua edhe me një analizë të kuadrit të brendshëm rregullator të Ministrisë (shqyrtim literature), i cili përfshin: kuadrin e brendshëm rregullator dhe strategjik të ministrisë, ku përmendet urdhri nr. 58, datë 5.2.2025, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregullores së brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”; urdhri nr. 2, datë 6.1.2017, i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar, si dhe të rregullores përkatëse nr. 948/1 prot., datë 30.1.2018, të njësisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për hetimin administrativ dhe ruajtjen e konfidencialitetit “Rregullore e njësisë përgjegjëse



për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve për hetimin administrativ dhe ruajtjen e konfidencialitetit”, rregullore dhe akte të tjera të brendshme, manuale, strategji apo dokumente politikash, ndërveprimi i rolit të koordinatorit të së drejtës së informimit me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndërveprimi i rolit të punonjësit të burimeve njerëzore me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Raporte të pavarura të kryera nga organizata ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile në vend mbi çështje që përfshihen në fushat e veprimtarisë së MA-së. Pjesë e këtij procesi u bë edhe realizimi i një takimi trajnimi të dedikuar² dhe takimi informues me grupin e punës dhe punonjësit e ministrisë për metodologjinë e vlerësimit të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Janë zhvilluar takime fokus grupe me drejtori të ndryshme brenda MA-së, duke evidentuar risqet reale përmes përshkrimit të praktikave konkrete, analizës institucionale dhe diskutimit mbi praktikat e brendshme të punës, të ekspozuara ndaj shkeljeve të integritetit, sjelljeve joetike e joprofesionale dhe parregullsive të tjera. Konkretisht, janë kryer takime me 6 drejtori, si përkatësisht: Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar; Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor; Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin; Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse; Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave; Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

2. Metoda sasiore: përmes vlerësimit me anë të një pyetësoi të strukturuar, *online*, ku punonjësit e ministrisë iu përgjigjën pyetjeve mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Pyetësoi i vlerësimit trajtoi nivelin e zbatimit të ligjit, procedurat e rekrutimit, vlerësimin e performancës, zhvillimin në karrierë, komunikimin e brendshëm, si dhe rolin e njësisë të brendshme teknike ministrisë. Këtij pyetësoi, punonjësit e ministrisë iu përgjigjën në mënyrë anonime. Anketimi përfshiu një kampion me 57 punonjës të institucionit me një nivel besueshmërie statistikore 95%. Marzhi i vlerësuar i gabimit është +/- 7%. Kampionimi kishte një shpërndarje të gjerë, për sa u përket gjinisë, moshës

dhe vjetërsisë në punë. Të anketuarit meshkuj përbëjnë 26% të kampionit krahasuar me punonjëset femra që janë 74%. 45% e stafit kanë mbi 10 vjet përvojë, çka garanton një vlerësim të pjekur të proceseve. Instrumenti i përdorur konsistoi në 62 pyetje strukturore, që mbulojnë etikën, procedurat dhe vendimmarrjen. Pyetësorët e strukturuar u plotësuan në mënyrë anonime nga stafi i ministrisë dhe u administruan në kujdesin e drejtpërdrejtë të drejtuesit të Grupit të Punës të hartimit të Planit të Integritetit. Gjetjet e pyetësorit paraqesin vetëvlerësimin e aparatit të Ministrisë së Arsimit, një hap i avancuar kritik në hartimin e Planit të ri të Integritetit 2026–2029.

Kombinimi i këtyre dy metodave ka mundësuar një analizë gjithëpërfshirëse dhe të balancuar të risqeve, duke garantuar një bazë të fortë për formulimin e masave të Planit të Integritetit dhe përmirësimin e administrimit të brendshëm. Procesi u bazua në standardet e kapitullit 23 të *Acquis* të Bashkimit Evropian dhe synon forcimin e etikës, transparencës dhe luftën kundër korrupsionit në administratën publike.

2. Përmbajtja e Planit të Integritetit

Ministria e Arsimit synon të përmirësojë proceset e qeverisjes së brendshme, të prezantojë standarde të larta transparence dhe llogaridhënieje në nivel institucioni, të promovojë një mjedis me standarde etike dhe profesionale dhe të prezantojë qasje dhe mekanizma të fokusuar në transparencë dhe llogaridhënie. Për të arritur këtë synim, MA-ja ka hartuar një Plan Integriteti për rritjen e transparencës dhe të integritetit, gjatë zbatimit të të cilit MA-ja do të trajtojë në kohë sfidat ekzistuese dhe do të rrisë ndjeshëm efikasitetin dhe transparencën e aktiviteteve të saj.

Përmirësimi dhe vendosja e standardeve të transparencës dhe integritetit në ministri do të ketë ndikim pozitiv edhe në qeverisjen dhe menaxhimin e brendshëm të institucionit. Qëllimet dhe objektivat e përcaktuar në planin e integritetit janë në përputhje me programin e reformës kundër korrupsionit të qeverisë shqiptare të formuluar në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 859, datë 26.12.2024, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, planit të veprimit 2024–2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës”. Në të

² Datë 10.3.2026.



njëjtën kohë, me përmbushjen e tyre do të sigurohet një kontribut i rëndësishëm për zbatimin e reformës në administratën publike dhe për prioritetet e përcaktuara në strategji të tjera kombëtare.

Përmbajtja e Planit të Integritetit paraqitet, si më poshtë:

- **Deklarata e Integritetit Institucional**, që është shprehja e vullnetit dhe e përkushtimit për integritet institucional nga ana e titullarit të Ministrisë së Arsimit;

- **Prezantimi i përgjithshëm i procesit të hartimit të Planit të Integritetit të MA-së**, që është përshkrimi i fazave të procesit të hartimit të Planit të Integritetit dhe qasja metodologjike;

- **Risqet e integritetit dhe faktorët e tyre**, që përfshin një përshkrim të risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre në të gjitha fushat e përgjegjësisë së institucionit, në përputhje me strukturën³ e miratuar të institucionit, nga të cilat 5 prej tyre, sipas orientimit bazë të MVRI-së;

- **Plani i veprimit**, që përmban masat parandaluese dhe të kontrollit që duhet të ndërmerren për të adresuar risqet e identifikuara dhe të vlerësuara.

Plani i Integritetit dhe pjesa integrale e tij që është plani i veprimit, i është vënë në dispozicion paraprakisht të gjithë stafit të Ministrisë së Arsimit për konsultim dhe njohje paraprake. Ai konsiderohet një dokument “i gjallë” dhe një instrument efektiv që orienton punët e përditshme drejt interesit publik, standardeve të larta profesionale dhe performancës së mirë institucionale.

3. Risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit

Në këtë seksion është paraqitur një përshkrim i përmblendhur i risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, të analizuara sipas fushave të veprimtarisë së MA-së dhe të kategorizuara, si më poshtë:

- Çështje të etikës dhe integritetit publik në Ministrinë e Arsimit;

- Administrimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, kapacitetet teknike dhe profesionale;

- Fusha e transparencës dhe komunikimit në Ministrinë e Arsimit;

- Mjedisi i brendshëm rregullator dhe i politikave të fushës për të promovuar integritetin,

llogaridhënien dhe parandaluar korrupsionin në fushën e arsimit.

3.1 Çështje të etikës dhe integritetit publik në Ministrinë e Arsimit (zbatimi i mekanizmave dhe instrumenteve, në përputhje me kuadrin ligjor mbi etikën dhe integritetin)

Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator të Ministrisë së Arsimit rezulton se ekzistojnë parashikime të përgjithshme, që lidhen me etikën dhe integritetin publik, të mbështetura në legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit, etikën në administratën publike, sinjalizimin dhe deklarimin e pasurisë. Megjithatë, evidentohet nevoja për konsolidimin dhe detajimin e mëtejshëm të këtyre rregullave në nivel institucional, si dhe për forcimin e mekanizmave të zbatimit të tyre në praktikë, duke i dhënë një rol më të dukshëm dhe ndikues strukturave të brendshme teknike (autoritetet përgjegjëse) të MA-së.

Ministria e Arsimit njeh rëndësinë e konsolidimit të burimeve njerëzore të përshtatshme për të zhvilluar kulturën dhe standardet etike, të cilat do të jenë përgjegjëse për përmirësimin e mjedisit në aspektin etik. Për të eliminuar risqet e korrupsionit, ministria e konsideron të rëndësishme vendosjen e masave parandaluese. Prandaj, në kuadër të këtij drejtimi strategjik, synimi i Ministrisë është forcimi i etikës dhe standardeve të larta të sjelljes, si dhe zvogëlimi i risqeve të korrupsionit.

Në veçanti, rregullat që lidhen me procesin e deklarimit dhe pranimit të dhuratave dhe administrimin e regjistrit përkatës, përfitimet e tjera të ngjashme (favore dhe përfitime), shpenzimet e mbuluara nga të tretët, deklarimin e takimeve me lobistë apo grupe interesi (në zbatim të kuadrit të ri ligjor), si dhe rregullat për veprimtaritë e jashtme të punonjësve dhe deklarimin e tyre, nevojiten të jenë të parashikuara në mënyrë të qartë dhe të unifikuar në një kuadër të brendshëm rregullator, siç është Kodi i Etikës i institucionit dhe po ashtu në rregulloren e brendshme të institucionit.

Rezulton se edhe pse ekzistojnë parashikime të tilla ligjore dhe detyra funksionale për zbatim, niveli i ndërgjegjësimit dhe komunikimit të tyre te stafi i MA-së, si dhe zbatimi efektiv në praktikë, paraqet probleme. Për rrjedhojë, evidentohen nevoja për

³ Miratuar me urdhër të Kryeministrit, nr. 186, datë 15.10.2025, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit”.



forcimin e mekanizmave të informimit dhe të trajnimit të punonjësve (ndërgjegjësim i shtuar i brendshëm dhe i jashtëm), në mënyrë që rregullat e etikës dhe të integritetit të njihen dhe të zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha nivelet e institucionit.

Në kuadër të menaxhimit të instrumenteve të integritetit, del e nevojshme përcaktimi i qartë i përgjegjësiave institucionale për monitorimin e zbatimit të rregullave të etikës dhe të integritetit, përfshirë rolin e strukturave përgjegjëse (si burimet njerëzore apo funksione të dedikuara për integritetin), si dhe forcimi i koordinimit ndërmjet tyre.

Lidhur me anëtarët dhe funksionarët politikë paraqiten mungesa në aktet e brendshme (rregullore) mbi mënyrën e komunikimit të tyre me drejtoritë e ministrisë dhe zyrtarët publikë duke krijuar paqartësi apo duke krijuar hapësira për mosrakordim veprimesh. Është e nevojshme të strukturohen kanalet e komunikimit dhe niveli hierarkik duke vijëzuar besueshmërinë dhe korrektësinë e çdo informacioni. Anëtarët e kabinetit duhet t'i nënshtrohen informimit dhe ndërgjegjësimit të rregullt dhe të vazhdueshëm mbi integritetin dhe korrupsionin për të shmangur çdo rast që mund të prekë dhe cenojnë mbarrëvajtjen e aktivitetit të tyre ditor në mbështetje të Ministrisë të Arsimit. Hartimi i një plani periodik, të miratuar për këtë qëllim, do të ishte i mirëpritur. Gjithashtu, këshilltarët e rinj të atashuar pranë kabinetit të ministrit duhet të marrë informacionet e duhura paraprake për integritetin dhe korrupsionin. Rezulton se duhet të përditësohet në kohë informacioni për përkrahje pune, mbi aktivitetin që kryejnë (fushat e veprimtarisë) së tyre.

Mbështetur në analizën e kuadrit të brendshëm rregullator të ministrisë, duhen përmirësime në drejtim të:

- përcaktimit të rregullave të qarta të komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet drejtorive dhe në përputhje me hierarkinë e stafit, përfshirë funksionarët politikë;
- parashikimit të standardeve të sjelljes në marrëdhëniet ndërmjet kolegëve dhe në raport me publikun;
- rregullimit të veprimtarive të jashtme të punonjësve dhe kufizimeve përkatëse sipas ligjit;
- ndalimit dhe parandalimit të përdorimit të burimeve publike për përfitime personale;

- forcimit të rregullave për parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit;

- respektimit të standardeve për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Gjithashtu, përveç përmirësimit të kuadrit të brendshëm rregullator, Ministria e Arsimit duhet të përfshijë në mënyrë të qëndrueshme sistemin e vlerësimit të riskut të integritetit si pjesë të kulturës së brendshme të punës. Një qasje proaktive ndaj integritetit dhe identifikimit të hershëm të faktorëve të riskut është e domosdoshme për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale, e cila rezulton të jenë informacioni i munguar tek anëtarët e stafit. Në këtë drejtim, vlerësimi periodik i risqeve të integritetit, i mbështetur në metodologjinë përkatëse, duhet të kryhet dhe vlerësohet gradualisht në strukturat e ministrisë, duke u shoqëruar me masa konkrete parandaluese dhe raportim të rregullt mbi zbatimin e tyre.

Sa më sipër, disa nga sfidat që identifikohen në mjedisin e brendshëm institucional mbi etikën dhe integritetin në MA, janë:

- forcimi i kulturës së integritetit në Ministrinë e Arsimit kërkon një qasje të integruar;
- përmirësimi i kuadrit rregullator të brendshëm;
- rritja e ndërgjegjësimit dhe e kapaciteteve të stafit për këto akte dhe e atyre që do jenë pjesë e strukturave monitoruese, të kontrollit dhe të raportimit.

3.2 Administrimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, kapacitetet teknike dhe profesionale

Integriteti publik është i lidhur ngushtë me komponentin e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore ku zbatohen vazhdimisht parimet bazë, si: meritokracia dhe transparenca, mbështetja e profesionalizmit në shërbimin publik, parandalon favorizimin dhe nepotizmin, bëhet pengesë për ndërhyrjet e panevojshme politike dhe zvogëlon rreziqet për shpërdorimin e detyrës dhe për sjelljet joetike dhe joprofesionale në institucion. Për këtë arsye, mbështetur në të dhënat e marra nga pyetësori i ndarë me stafin e përfshirë dhe rekomandime dhe adresime të raporteve të dhëna për këtë dikaster, ministria synon të promovojë një sektor publik të aparatit të saj të bazuar në merita, profesionalizëm, të përkushtuar ndaj vlerave të shërbimit publik dhe qeverisjes së mirë.



Nga shqyrtimi i praktikave të brendshme të Ministrisë së Arsimit, menaxhimi i burimeve njerëzore paraqet nevojë për konsolidim në disa aspekte kryesore, që lidhen me proceset e rekrutimit, promovimit, lëvizjes dhe largimit nga detyra, si dhe me menaxhimin e kapaciteteve profesionale të stafit. Këto procese kërkojnë të jenë të mbështetura në procedura të qarta, të standardizuara dhe të monitoruara në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim minimizimin e risqeve që mund të cenojnë integritetin e institucionit.

Në këtë drejtim, adresohet nevoja për ndërhyrje në:

- përcaktimin dhe formalizimin e procedurave standarde të punës (PSV) për funksionet kryesore të institucionit, me qëllim rritjen e qartësisë në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi;

- përditësimin dhe harmonizimin e përshkrimeve të punës, në përputhje me funksionet reale të ushtruara nga strukturat përkatëse;

- forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në proceset e rekrutimit, promovimit dhe lëvizjes së stafit, për të shmangur raste të mundshme të konfliktit të interesit, favorizimit apo ndikimeve të jashtme.

Një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të burimeve njerëzore lidhet me kapacitetet profesionale të stafit dhe zhvillimin e tyre të vazhdueshëm. Në këtë drejtim, rezulton se është e nevojshme forcimi i sistemit të trajnimeve, përmes pasjes së një strategjie për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin profesional, si dhe promovimin e numrit të punonjësve, të cilët marrin pjesë në trajnime dhe programe të tjera të zhvillimit profesional çdo vit. Më konkretisht gjendet me vend të kryhet:

- identifikimi i nevojave reale për trajnim në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e secilës drejtori në MA;

- zhvillimit të programeve të strukturuar të trajnimit, përfshirë temat e integritetit, etikës, konfliktit të interesit dhe mekanizmave të parandalimit të korrupsionit;

- vendosjes së mekanizmave të vlerësimit të efektivitetit të trajnimeve dhe përdorimit të marrjes së një kontributi për përmirësimin e tyre.

Sa më sipër, disa nga sfidat që identifikohen në çështjen e zhvillimit të burimeve njerëzore të MA, janë:

- forcimi i zbatimit të parimeve të meritokracisë, transparencës dhe profesionalizmit në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore (rekrutimi, promovimi, lëvizja dhe largimi nga detyra);

- përmirësimi dhe standardizimi i procedurave të brendshme të punës, përfshirë formalizimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) dhe përditësimin e përshkrimeve të punës, në përputhje edhe me angazhimet e drejtorive të brendshme teknike edhe kundrejt Planit të Rritjes (RGF), apo stafe administrojnë dhe menaxhojnë fonde të BE-së;

- rritja e kapaciteteve profesionale të stafit, nëpërmjet zhvillimit të programeve të strukturuar dhe të përshtatura të trajnimit, veçanërisht në fushat e etikës dhe të integritetit;

- forcimi i mekanizmave të informimit dhe të ndërgjegjësimit të stafit mbi kuadrin rregullator të brendshëm dhe detyrimet që rrjedhin prej tij;

- konsolidimi i rolit dhe i funksionimit të strukturave përgjegjëse për integritetin dhe kontrollin e brendshëm dhe, specifikisht, për ato drejtori dhe struktura që kanë ose mund të kenë ndërveprim me fonde dhe autoritete të huaj, si dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi funksionet e tyre.

3.3 Fusha e transparencës dhe e komunikimit në Ministrinë e Arsimit

Në drejtim të rritjes së transparencës, ministria i jep prioritet publikimit të rregullt të të dhënave për informimin e publikut. Po ashtu, shqyrtimi dhe zhvillimi i parimeve të transparencës lehtëson publikimin rregullisht të dhënave dhe informacionet për aparatin e ministrisë.

Nga vlerësimi i praktikave të transparencës dhe të komunikimit në Ministrinë e Arsimit, rezulton se institucioni ka avancuar në publikimin e informacionit me karakter informues dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor për të drejtën e informimit. Në faqen zyrtare të institucionit publikohen të dhëna dhe dokumente që lidhen me veprimtarinë e ministrisë, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe informimit të publikut.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit është caktuar me akt administrativ (urdhri nr. 66, datë 9.3.2026, i Sekretarit të Përgjithshëm, “Për caktimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në Ministrinë e Arsimit”) dhe përbën një faktor kyç në menaxhimin e kërkesave për informacion. Megjithatë, efektiviteti i këtij funksioni varet në masë



të konsiderueshme nga bashkëpunimi dhe koordinimi i brendshëm ndërmjet drejtorive të ministrisë, si dhe nga qartësia e procedurave për përpunimin dhe publikimin e informacionit. Në këtë drejtim, evidentohet nevoja për përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator (rregullore e brendshme) përmes përcaktimit të rregullave të qarta për ndërveprimin ndërmjet strukturave të ministrisë dhe koordinatorit për të drejtën e informimit, si dhe për standardizimin e praktikave të trajtimit të kërkesave për informacion dhe publikimit proaktiv të të dhënave.

Një aspekt i rëndësishëm lidhet, gjithashtu, me menaxhimin e të dhënave dhe respektimin e standardeve për mbrojtjen e tyre. Në këtë kuadër, kërkohet të rritet përdorimi i politikave të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe rritja e kapaciteteve të stafit për zbatimin e tyre në praktikë.

Në drejtim të transparencës dhe komunikimit me publikun, rezulton se përmirësimi i praktikave ekzistuese është i lidhur ngushtë me kapacitetet aktuale profesionale të stafit dhe nivelin e ndërgjegjësimit të tyre për detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor. Për rrjedhojë, evidentohet nevoja për forcimin e trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjëse në fushën e së drejtës së informimit, menaxhimit të të dhënave dhe publikimit të informacionit, përfshirë edhe formatet e të dhënave të hapura.

Sa më sipër, disa nga sfidat që identifikohen në çështjen e transparencës institucionale të MA, janë:

- përmirësimi i kuadrit të brendshëm rregullator në fushën e transparencës dhe aksesit në informacion;
- forcimi i koordinimit dhe i komunikimit të brendshëm ndërmjet drejtorive dhe strukturave përgjegjëse për menaxhimin e informacionit;
- rritja e kapaciteteve profesionale të stafit, në lidhje me të drejtën e informimit, menaxhimin dhe publikimin e të dhënave;
- përmirësimi i praktikave të publikimit proaktiv dhe rritja e aksesueshmërisë së informacionit për publikun.

3.4 Mjedisi i brendshëm rregullator dhe i politikave të fushës për të promovuar integritetin, llogaridhënien dhe parandaluar korrupsionin në fushën e arsimit

Vizioni i Ministrisë për sektorin e arsimit është ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin. Ministria e Arsimit është e vetëdijshme, se menaxhimi efektiv dhe efikas i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet mund të arrihet duke u bazuar në mekanizma funksionalë për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies. Realizimi i këtij vizioni kërkon një mjedis rregullator dhe politikash të qëndrueshme, të bazuar në transparencë, llogaridhënie dhe mekanizma efektivë të kontrollit dhe monitorimit.

Nga analiza e funksionimit të proceseve kryesore në fushën e arsimit rezulton se ministria ushtron një rol qendror në hartimin e politikave, zhvillimin e kuadrit rregullator, mbikëqyrjen e institucioneve të arsimit dhe menaxhimin e burimeve publike (njerëzore dhe financiare). Këto funksione, për nga natyra e tyre, paraqesin ekspozim ndaj risqeve të integritetit, veçanërisht në proceset që lidhen me:

- hartimin e politikave dhe programeve arsimore;
- ndërveprimin me institucionet e arsimit të lartë dhe parauniversitar;
- vendimmarrjen për licencime, programe studimi dhe shpërndarje fondesh;
- proceset rregullatore dhe hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore;
- menaxhimin e të dhënave dhe përdorimin e tyre për vendimmarrje;
- proceset financiare dhe të prokurimit publik.

Në këtë kuadër, rol të veçantë luajnë Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave sektoriale. Për nga natyra e funksioneve të tyre, këto struktura mund të jenë të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit në proceset e hartimit të kurrikulave dhe programeve arsimore, ndërveprimit me institucionet arsimore, si dhe në vendimmarrjen që lidhet me programe studimi, kuota, financim dhe mbështetje për kërkimin shkencor. Këto procese kërkojnë nivele të larta transparence, dokumentimi dhe kontrolli për të shmangur hapësirat për ndikim të interesave të veçantë, apo trajtim preferencial.

Në këtë kontekst, nga vlerësimi i kryer evidentohet se proceset e hartimit dhe i zbatimit të politikave kërkojnë një nivel të lartë transparence,



dokumentimi dhe gjurmueshmërie të vendimmarrjes, me qëllim shmangien e hapësirave për ndikim të interesave të veçantë, apo përzgjedhje jo të balancuar të objektivave. Po ashtu, ndërveprimi me aktorë të jashtëm, dhe për më tepër institucionet arsimore, grupet e interesit të fushës dhe partnerët e ndryshëm (vendës dhe të huaj), kërkon rregulla të qarta dhe mekanizma kontrolli për të garantuar integritetin e proceseve vendimmarrëse. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për proceset që zhvillohen në nivel të drejtorive përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe atë të lartë, ku përmbajtja e politikave dhe vendimmarrja kanë ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin e sistemit arsimor.

Nga pikëpamja e derregullimit, evidentohet nevoja për forcimin e standardizimit të proceseve të hartimit të akteve, si dhe për aplikimin e mekanizmave për vlerësimin e hapësirave për korrupsion dhe risqeve të korrupsionit në legjislacion (p.sh. instrumente si vlerësimi i riskut të korrupsionit në ligje). Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushat ku vendimmarrja përfshin një nivel të lartë diskrecioni dhe konsiderohet element kyç edhe i vlerësimit të riskut të korrupsionit në fushën e arsimit.

Në drejtim të menaxhimit të të dhënave dhe monitorimit të politikave, evidentohet rëndësia e sigurimit të saktësisë, integritetit dhe transparencës së informacionit, duke qenë se këto të dhëna shërbejnë si bazë për vendimmarrje. Proceset e raportimit dhe verifikimit të të dhënave kërkojnë standardizim dhe mekanizma të fortë kontrolli për të shmangur risqet e manipulimit, apo përdorimit selektiv të informacionit.

Një tjetër element thelbësor për funksionimin efektiv të këtij mjedisi rregullator dhe politikash mbetet kapaciteti njerëzor i institucionit. Evidentohet se siguri i një stafi të qëndrueshëm, të kualifikuar dhe të mjaftueshëm në numër është faktor kyç për garantimin e cilësisë së politikave, vendimmarrjes dhe proceseve zbatuese. Ekzistenca e vakancave në pozicione kyçe, si dhe qarkullimi i shpeshtë i stafit, mund të ndikojë negativisht në vazhdimësinë institucionale, në ruajtjen e “kujtesës” administrative dhe në cilësinë e proceseve vendimmarrëse.

Në këtë drejtim, rezulton nevoja për forcimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, me fokus në plotësimin në kohë dhe mirë të

pozicioneve vakante, tërheqjen dhe mbajtjen e profesionistëve të kualifikuar, si dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit ekzistues. Investimi në kapacitetet njerëzore përbën një parakusht për rritjen e integritetit institucional dhe për garantimin e një sistemi arsimor të qëndrueshëm dhe cilësor.

Sa më sipër, disa nga sfidat që identifikohen në mjedisin e brendshëm rregullator dhe të politikave të fushës dhe mjeteve të vlerësimit kundër korrupsionit në MA, janë:

- forcimi i transparencës dhe i gjurmueshmërisë në proceset e hartimit dhe të zbatimit të politikave arsimore;

- reduktimi i hapësirave për korrupsion dhe ndikim të interesave të veçantë në vendimmarrje;

- përmirësimi i standardizimit të proceseve rregullatore dhe aplikimi i instrumenteve për identifikimin e risqeve të korrupsionit në legjislacion;

- forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit në marrëdhëniet me institucionet arsimore dhe aktorët e jashtëm;

- rritja e integritetit dhe transparencës në menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave për vendimmarrje;

- përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional dhe i mekanizmave të llogaridhënies në sektorin e arsimit;

- forcimi i kapaciteteve institucionale dhe siguri i një stafi të qëndrueshëm dhe të kualifikuar, si faktor kyç për cilësinë e politikave dhe vendimmarrjes.

4. Plani i veprimit: zbatimi, monitorimi dhe raportimi

Plani i veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të identifikuar sipas 6 fushave themelore të përgjegjësisë së MA-së. Ai është një mjet plotësues i politikave dhe i kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional. Plani ka për qëllim arritjen e objektivave për forcimin e integritetit, si më poshtë:

1. Zbatimi i mekanizmave dhe i instrumenteve në përputhje me kuadrin ligjor mbi etikën dhe integritetin publik.

Ky objektiv ka për qëllim forcimin e zbatimit efektiv të kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e etikës dhe integritetit publik në Ministrinë e Arsimit. Nga analiza e kryer rezultojnë se, pavarësisht



ekzistencës së një baze ligjore dhe instrumenteve përkatëse, sfida kryesore mbetet në zbatimin e tyre të mirë dhe funksional në praktikë, si dhe në ndërgjegjësimin e stafit mbi detyrimet që rrjedhin prej tyre.

Risqet e identifikuar lidhen kryesisht me mungesën e standardizimit të praktikave të zbatimit, nivelin e pamjaftueshëm të informimit dhe ndërgjegjësimin të stafit, si dhe me paqartësi në rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të brendshme përgjegjëse për monitorimin e integritetit. Për këtë arsye, ndërhyrjet e masave fokusohen në forcimin e mekanizmave të zbatimit, përmirësimin e koordinimit institucional dhe rritjen e kapaciteteve të stafit për të përdorur në mënyrë efektive instrumentet e integritetit.

Rezultati i synuar është krijimi i një mjedisi institucional më funksional dhe të orientuar drejt zbatimit të qëndrueshëm të rregullave të etikës dhe integritetit, duke kontribuar në reduktimin e risqeve të korrupsionit dhe forcimin e llogaridhënies në institucion.

2. Administrimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, kapacitetet teknike dhe profesionale

Ky objektivi ka për qëllim përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale në Ministrinë e Arsimit, si element kyç për garantimin e integritetit institucional dhe cilësisë së proceseve vendimmarrëse.

Nga analiza e kryer rezulton se menaxhimi i burimeve njerëzore përbën një fushë me ndikim të drejtpërdrejtë në integritetin e institucionit, duke qenë i ekspozuar ndaj risqeve që lidhen me mungesën e standardizimit të proceseve, vakancat në pozicione kyçe, lëvizjen e stafit dhe nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional, apo si pasojë e ngarkesave në punë. Këto faktorë mund të ndikojnë në cilësinë e politikave, në ruajtjen e vazhdimësisë institucionale dhe në efektivitetin e zbatimit të tyre.

Për këtë arsye, ndërhyrjet e masave fokusohen në përmirësimin e proceseve të menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimin e transparencës dhe meritokracisë në rekrutim dhe promovim, si dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve dhe programeve të zhvillimit profesional.

Rezultati i synuar është krijimi i një administrate të qëndrueshme, profesionale dhe të aftë për të zbatuar në mënyrë efektive politikat dhe

mekanizmat e integritetit, duke kontribuar në uljen e risqeve të korrupsionit dhe rritjen e performancës institucionale.

3. Fusha e transparencës dhe komunikimit në Ministrinë e Arsimit

Ky objektivi ka për qëllim përmirësimin e transparencës dhe komunikimit institucional në Ministrinë e Arsimit, si element thelbësor për rritjen e llogaridhënies dhe besimit të publikut në institucion.

Nga analiza e kryer rezulton se, pavarësisht ekzistencës së instrumenteve dhe detyrimeve ligjore në fushën e së drejtës së informimit dhe transparencës, sfida mbetet përdorimi i tyre efektiv në praktikë, si dhe siguri i një qasjeje të unifikuar në publikimin dhe menaxhimin e informacionit. Risqet e identifikuar lidhen kryesisht me mungesën e standardizimit të praktikave të publikimit të të dhënave, koordinimin e pamjaftueshëm ndërmjet strukturave të brendshme, si dhe me kapacitetet e kufizuara të stafit për menaxhimin dhe komunikimin e informacionit.

Për këtë arsye, ndërhyrjet e masave fokusohen në përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator për transparencën, forcimin e mekanizmave të koordinimit ndërmjet strukturave përgjegjëse dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit për menaxhimin, publikimin dhe komunikimin e informacionit.

Rezultati i synuar është krijimi i një sistemi transparent dhe funksional të komunikimit institucional, që garanton akses të rregullt dhe të besueshëm të publikut në informacion, si dhe përmirëson llogaridhënien e institucionit.

4. Mjedisi i brendshëm rregullator dhe i politikave të fushës për të promovuar integritetin, llogaridhënien dhe parandaluar korrupsionin në fushën e arsimit

Ky objektivi ka për qëllim përmirësimin e mjedisit të brendshëm rregullator dhe të politikave sektoriale në Ministrinë e Arsimit, me qëllim garantimin e proceseve vendimmarrëse transparente, të gjurmueshme dhe të mbrojtura nga ndikime të papërshtatshme dhe në risk integriteti.

Nga analiza e kryer rezulton se funksionet kryesore të ministrisë në hartimin e politikave, zhvillimin e kuadrit rregullator, mbikëqyrjen e institucioneve arsimore dhe menaxhimin e burimeve publike janë të ekspozuara ndaj risqeve të integritetit, veçanërisht në rastet kur proceset nuk



janë të standardizuara, dokumentimi i vendimmarrjes është i pamjaftueshëm, apo ekzistojnë hapësira për diskrecion dhe ndikim të interesave të veçantë.

Risqet e identifikuar lidhen kryesisht me proceset e hartimit të politikave dhe programeve arsimore, ndërveprimin me institucionet e arsimit të lartë dhe parauniversitar, vendimmarrjen për licencime dhe programe studimi, si dhe me menaxhimin e të dhënave dhe përdorimin e tyre për vendimmarrje.

Për këtë arsye, ndërhyrjet e masave fokusohen në përmirësimin e standardizimit të proceseve, forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit, rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së vendimmarrjes, si dhe në aplikimin e instrumenteve për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në legjislacion dhe politika.

Për arritjen e këtij objekti, parashikohen katër nënobjektiva që adresojnë nevojën për fushat kryesore të funksionimit të ministrisë në nivel sektorial:

Objekti i specifik 4.1: Fusha e politikave dhe programeve të zhvillimit të arsimit

Qëllimi i këtij nënobjekti është rritja e transparencës dhe adresimit në proceset e hartimit të politikave dhe programeve arsimore, përmes përmirësimit të dokumentimit të vendimmarrjes dhe forcimit të mekanizmave të konsultimit dhe përfshirjes së aktorëve të fushës.

Rezultati i synuar është një pasja e procesi vendimmarrës transparent dhe i mbrojtur nga ndikime të papërshtatshme, që garanton cilësi dhe barazi në zhvillimin e politikave arsimore.

Objekti i specifik 4.2: Fusha e programimit, standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator në arsim

Qëllimi i këtij nënobjekti është përmirësimi i proceseve të hartimit të kuadrit rregullator, përmes standardizimit të procedurave dhe aplikimit të instrumenteve për identifikimin e risqeve të korrupsionit në legjislacion.

Rezultati i synuar është një kuadër rregullator më i qartë, i qëndrueshëm dhe i harmonizuar, që redukton hapësirat për interpretim subjektiv dhe rrit sigurinë juridike.

Objekti i specifik 4.3: Fusha e lejeve, licencave dhe monitorimit të shërbimeve

Qëllimi i këtij nënobjekti është rritja e transparencës dhe kontrollit në proceset vendimmarrëse që lidhen me licencimet, lejet dhe monitorimet e institucioneve arsimore, përmes qartësimit të procedurave dhe forcimit të mekanizmave të monitorimit.

Rezultati i synuar është reduktimi i hapësirave për korrupsion dhe ndikim të jashtëm, si dhe garantimi i një trajtimi të barabartë për të gjitha subjektet e interesuara.

Objekti i specifik 4.4: Fusha e jetësimit të prioritetëve dhe statistikave

Qëllimi i këtij nënobjekti është sigurimi i saktësisë, integritetit dhe transparencës së të dhënave që përdoren për vendimmarrje, përmes forcimit të proceseve të raportimit, verifikimit dhe analizës së tyre.

Rezultati i synuar është një sistem më i besueshëm i menaxhimit të të dhënave, që mbështet vendimmarrjen dhe redukton risqet e manipulimit apo përdorimit selektiv të informacionit.

Gjatë procesit të zbatimit të Planit të Integritetit, MA-ja do të udhëhiqet nga parimet bazë të mëposhtme:

- Llogaridhënia dhe transparenca: gjatë zbatimit të Planit të Integritetit, ministria do t'u ofrojë informacion në kohë të gjitha palëve të interesuara për aktivitetet (planin e veprimit) të kryera prej saj.

- Pjesëmarrja qytetare: në përmbylljen e synimeve dhe objektivave të përcaktuar në këtë plan integriteti, ministria do të bashkëpunojë me aktorët e interesuar, organizatat vendëse, si dhe ato ndërkombëtare, dhe do të marrë parasysh mendimet dhe ekspertizën e tyre.

- Qasja e bazuar në evidencë: Plani i Integritetit dhe masat e planifikuara në kuadër të tij bazohen në një analizë gjithëpërfshirëse të situatës dhe fakteve.

- Qasje e orientuar drejt rezultatit: ministria në kuadrin e Planit të Integritetit ka përcaktuar synime dhe objektiva realistë, përmbyllja e të cilave mund të verifikohet me tregues të matshëm.

- Transparenca e procesit dhe konsultimi publik: ministria e përgatiti Planin e Integritetit me mbështetjen e vetëvlerësimit të udhëhequr nga Grupi i brendshëm i Punës, dhe me përfshirjen e stafit të aparatit të ministrisë.

- Qasja për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore: ministria angazhohet drejt sigurimit të shërbimeve me cilësi të lartë për qytetarët dhe institucionet arsimore në



mënyrë transparente, efektive dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative, në përputhje me kërkesat e integritetit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave eficiente.

Zbatimi i plotë i masave të parashikuara në Planin e Integritetit do të përmirësojë ndjeshëm proceset e qeverisjes së brendshme të institucionit dhe standardet e transparencës, nëpërmjet të cilave do të krijohen parakushtet për përmirësimin e integritetit të ministrisë. Për më tepër, aktivitetet e planit të veprimit i janë në të njëjtën linjë me programin e ministrisë për luftën kundër korrupsionit dhe për forcimin e administratës publike me etikë dhe profesionalizëm.

Plani i Integritetit i Ministrisë së Arsimit për periudhën 2026–2029 parashikon katër objektiva strategjike, brenda të cilave parashikohen aktivitete të ndryshme. Për zbatimin e tyre, ministria ka hartuar një plan të detajuar veprimi, i cili për secilin objektiv përcakton funksionin/njësine përgjegjëse për zbatimin e tij, si dhe afatin kohor.

Për t'u siguruar që plani i veprimit zbatohet në kohë dhe në mënyrë efektive, ministria do të bëjë monitorimin e saj vazhdimisht dhe do të vlerësojë se në çfarë mase janë realizuar objektivat dhe aktivitetet e planifikuara në Planin e Integritetit. Monitorimi është periodik (mbi baza 6-mujore dhe vjetore) dhe evidenton kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve, apo grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në planin e veprimit. Nga monitorimi do të përcaktohet nëse masat e zbatuara kanë qenë efikase, nëse janë evidentuar ndryshime në kontekstin institucional, apo edhe të vetë risqeve. Ai synon të vlerësojë nëse masat e planifikuara janë zbatuar sipas afateve; nëse masat kanë qenë efektive në uljen e risqeve të identifikuar; nëse kanë ndodhur ndryshime në kontekstin institucional, procedurat, veprimet apo sjelljet që ndikojnë në riskun e identifikuar; nëse risqet ekzistuese janë rritur, zvogëluar ose transformuar; nëse kërkohet rishikimi i masave ose riformulimi i prioriteteve të riskut.

Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për trajtimin

e risqeve të integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili përgjigjet për ecurinë e zbatimit, Koordinatori i Integritetit.

Vlerësimi do të kryhet duke u mbështetur në instrumentin⁴ kornizë të monitorimit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Gjatë vlerësimit, së bashku me rezultatet, do të merren parasysh rrethanat e reja dhe, nëse është e nevojshme, do të rishikohet edhe plani i veprimit. Për të garantuar transparencën e procesit, ministria do të publikojë një raport për zbatimin e planit të veprimit dhe do të organizojë debate publike për të duke angazhuar të gjithë aktorët.

Më konkretisht, hapat që ndjek Koordinatori i Integritetit në procesin e monitorimit janë:

1. Njoftimi për fillimin e monitorimit dhe vënia në dispozicion e dokumenteve për plotësim;
2. Mbledhja e informacionit **nga njësitet zbatuese sipas formatit standard;**
3. Verifikimi i të dhënave të zbatimit, produktet e matshme të Planit të Integritetit, **që mund të jenë: procedura/manualë, dokumente, statistika, materiale trajnimi, publikime, evidenca të komunikimit me publikun/grupe interesi; takime trajnimi etj.;**
4. Analiza e ndikimit të masave **mbi riskun përkatës;**
5. Identifikimi i masave problematike, **vonesave dhe shkaktarëve të mundshëm të tyre;**
6. Propozimi i masave korrigjuese **ose riformulimi i masave në raste të nevojshme (hapat e tjerë);**
7. Përgatitja e raportit të monitorimit, **sipas formatit zyrtar;**
8. Paraqitja e raportit për miratim **pranë titullarit të institucionit;**
9. Publikimi i raportit, **sipas kërkesave të transparencës institucionale.**

Raporti i monitorimit, i jep mundësinë drejtuesve të MA-së të ndërmarrin masa përmirësuese, të rishikojë prioritetet dhe të forcojë mekanizmat e brendshëm të integritetit.

⁴ Miratuar me urdhër nr. 553, datë 30.9.2021, të ministrit të Drejtësisë. Metodologjia mund të aksesohet në linkun: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-faqe/8558>



Objektivi 1: Zbatimi i mekanizmeve dhe instrumenteve në përputhje me kuadrin ligjor mbi etikën dhe integritetin publik

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i riskut/ tipi i ndikimit)	Risku i brendshëm	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
1	Nuk është hartuar Kodi i Etikës për ministrinë.	Veprimtaria/ reputacioni dhe imazhi i institucionit	I lartë	1. Kodi i Etikës së ministrisë të parashikojë standardet e sjelljes së mirë për stafin politik/kabinetin dhe zyrtarët publikë. 2. Informimi/trajnimi i brendshëm i stafit të ministrisë për përmbajtjen e Kodit të Etikës.	1. Grup pune me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për të hartuar Kodin e Etikës për ministrinë; Gjashtëmujori i dytë 2026. 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdimësi.
2	Nuk është e përditësuar rregullorja e brendshme e ministrisë.	Veprimtari	Mesatar	1. Rishikimi i rregulloreve të brendshme, të miratuara me urdhrin nr. 58, datë 5.2.2025, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për miratimin e rregulloreve të brendshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, në përputhje me analizën e riskut të kryer, në përmbajtje të këtij PI. 2. Informimi i stafit për rregulloren. 3. Mbledhje vjetore për rregulloren.	1&2. Grupi i punës me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i parë 2026. 3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdimësi
3	Nuk janë hartuar ende rregulloret e brendshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale.	Veprimtari/ reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	Hartimi, miratimi dhe publikimi në faqen e internetit i rregulloreve të brendshme, për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale, në nivel institucioni.	Grup pune me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore + SP; Gjashtëmujori i dytë 2026.
4	Njohuri të kufizuara teknike nga punonjësit e ministrisë për rregullat e etikës, konfliktin e interesit, deklarin e dhuratave, veprimtaritë e jashtme, si dhe mosdiskriminimin.	Burimet njerëzore/ reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	1. Përfshirja në planin vjetor të trajnimeve të ministrisë së moduleve të trajnimit dhe realizimi i takimeve informuese periodike për këto çështje. 2. Trajnime të kryera	1&2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me ASPA); Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi
5	Përbërja e autoritetit përgjegjës të KI-së në ministri nuk është i përditësuar me ndryshimet e burimeve njerëzore që ka pësuar Drejtoria e Burimeve Njerëzore (aktualisht në përbërje të saj janë specialistë të drejtorive të ndryshme të ministrisë).	Burimet njerëzore/ reputacioni dhe imazhi i institucionit	Mesatar	1. Ngritja e autoritetit përgjegjës brenda Drejtorisë së Miradministrimit të Burimeve Njerëzore me punonjës të kësaj drejtorie me urdhër të ministrit të Arsimit. 2. Informimi i punonjësve të ministrisë për këtë urdhër dhe publikimi i tij. 3. Parashikimi në rregulloren brendshme të ministrisë i autoritetit përgjegjës për KI-në, roli dhe funksionet e tij.	1&2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2026 3. Grup pune me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i dytë 2026.
6	Njohuri të kufizuara të punonjësve të ministrisë për procesin e KI dhe ekzistencën e autoritetit përgjegjës në ministri.	Veprimtari	Mesatar	1. Organizimi i takimeve të rregullta informuese me të gjithë punonjësit e MA-së për rregulloren e KI-së, autoritetin përgjegjës dhe procesin. 2. Organizimi i trajnimeve periodike për KI dhe deklarin e dhuratave me stafin politik/kabinetin e ministrit.	1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i parë 2026 në vijimësi 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i parë 2027.



7	Mungesë e zbatimit të rregullave për mbrojtjen e sinjalizuesve.	Veprimtari/njësia përgjegjëse, sipas ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i ndryshuar	Mesatar	1. Krijimi i një linje të sigurt (online/ fizike) për raportim anonim. 2. Ideimi dhe zhvillimi i fushatave ndërgjegjësimi (vjetore).	1&2. Njësia përgjegjëse 2026 e në vijim.
8	Perceptimi për përdorimin e pozicionit të punës për lehtësi personale ose favorizime informale	Veprimtari/të gjitha drejtoritë në bashkëpunim me Burimet Njerëzore	Mesatar	Hartimi i një udhëzuesi praktik mbi etikën me raste studimore dhe nënshkrimi i Deklaratës së Integritetit.	Të gjitha drejtoritë në bashkëpunim me Burimet Njerëzore 2026 e në vijim.
9	Mungesa e trajnimeve dhe rregullave të qarta për trajtimin e dokumenteve konfidenciale.	Veprimtari/të gjitha drejtoritë në bashkëpunim me Burimet Njerëzore	Mesatar	Trajnimi i detyrueshëm për Sigurinë e Informacionit.	Të gjitha drejtoritë në bashkëpunim me Burimet Njerëzore 2026 e në vijim.
10	Vlerësimi i performancës si proces formal dhe mungesa e meritokracisë në rekrutime dhe lëvizje në detyrë.	Veprimtari/Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Mesatar	Kalimi në sistemin e vlerësimit të punonjësve bazuar në KPI (indikatore performance të matshëm).	Drejtoria e Burimeve Njerëzore 2026 e në vijim.

Objektivi 2: Administrimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore, kapacitetet teknike dhe profesionale

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i riskut/ tipi i ndikimit)	Risku i brendshëm	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
11	Analiza paraprake për lëvizjen e personelit në kuadër të ristrukturimit të ministrisë nuk ka qenë gjithëpërfshirëse.	Veprimtari	Mesatar	1. Kryerja e analizës së nevojave si parakusht i ndryshimeve strukturore, përmes përfshirjes së të gjithë personelit. 2. Informimi i personelit të ministrisë për analizën e kryer. 3. Përcaktimi i këtij detyrimi në rregulloren e brendshme të ministrisë.	1&2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Kur kryhet ristrukturimi, 2026 dhe në vazhdimësi. 3. Grup pune me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i dytë 2026.
12	Punonjësit e ministrisë angazhohen në detyra të tjera shtesë, që në disa raste, nuk përputhen me detyrat kryesore të tyre.	Veprimtari	I lartë	1. Caktimi i punonjësve në grupe të ndryshme pune në ministri të bëhet pas konsultimit nga njësia propozuese/kabineti i ministrit me eprorin e njësisë ku nëpunësi kryen punën kryesore. 2. Caktimi i detyrave shtesë për nëpunësit civilë të bëhet duke iu referuar përshkrimit të tyre të punës në mënyrë që detyrat shtesë të jenë të lidhura me detyrat kryesore. 3. Këto detyrime të parashikohen në rregulloren e brendshme të ministrisë.	1 & 2. Të gjitha drejtoritë; Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdimësi. 3. Grup pune me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i dytë 2026.
13	Mungesa e rregullave të brendshme për procesin e dorëzimit të detyrës dhe informacioneve të lidhura me të në rastin e largimit nga puna të punonjësve.	Veprimtari	I ulët	1. Hartimi i rregullave për dorëzimin e detyrës nga punonjësit në rastin e largimit nga puna. 2. Informim dhe komunikim i rregullave të stafi i MA-së.	1 & 2. Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026.
14	Vonesa në procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve dhe kryerja e një procesi formal.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	1. Dërgimi nga DBNJ-ja i njoftimeve paraprake drejtuesve të drejtorive për afatet e procesit të vlerësimit të performancës. 2. Realizimi nga DBNJ-ja i takimeve informuese periodike për personelin drejtues për procesin e vlerësimit.	1 & 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; 2026 (Çdo 6 muaj)
15	1. Plani vjetor i trajnimeve për punonjësit e ministrisë nuk është hartuar në bazë të identifikimit të nevojave për trajnime të punonjësve. 2. Mungon sistemi i brendshëm i vlerësimit të trajnimeve.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	1. Plani vjetor i trajnimeve të ministrisë të hartohet në mbështetje të nevojave të identifikuar të punonjësve. 2. Realizimi i vlerësimit të ndikimit të trajnimeve të punonjësve dhe miratimi i formatit të vlerësimit të ndikimit të	1, 2 & 3. Drejtoria e Miradministrit të Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdimësi.



				trajtimeve te punonjësit e ministrisë. 3. Kryerja e një vlerësimi vjetor për trajnimet në ministri dhe informimi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për këtë vlerësim.	
16	Vendimet e gjykatave të formës së prerë për rikthimin në detyrë të punonjësve të larguar nuk janë ekzekutuar plotësisht.	Burimet Njerëzore/ Financiar	Mesatar	1. Analizë vjetore e gjendjes së vendeve vakante dhe vlerësimi i mundësisë së plotësimit të tyre nga personat që kanë fituar me vendime të formës së prerë rikthimin në vendin e punës. 2. Mbledhja e Komisionit për Rikthimin në detyrë të ministrisë dhe parashtrimi i analizës së kryer në mbledhje.	1. Grup pune me punonjës nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Gjashtëmujori i dytë 2026 2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore +SP; Gjashtëmujori i dytë 2026.
17	Nevoja për përditësim të njohurive për punonjësit e Sektorit të Këshillimit të Çështjeve Ligjore për procedurat administrative, ndjekjen e proceseve gjyqësore, etikën, KI etj.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	Parashikimi në planin vjetor të trajtimeve të ministrisë trajnime për Kodin e Procedurës Administrative, proceset gjyqësore, etikën, KI, procedurat administrative etj.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me ASPA-n, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve); Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.
18	1. Kryerja e takimeve raportuese/informuese periodike, për realizimin e punës, në nivel drejtorie nuk është parashikuar në rregulloren e brendshme të ministrisë. 2. Mbledhjet e përbashkëta me drejtoritë e tjera të ministrisë dhe ndarja e raporteve/analizave të punës mes drejtorive të ministrisë nuk kryhet në mënyrë periodike. 3. Mungesa e formateve të raportimit periodik të punës nga ana e punonjësve të ministrisë.	Veprimtari	Mesatar	1. Parashikimi i detyrimit të mbajtjes së takimeve/mbledhjeve periodike raportuese në nivel drejtorie në rregulloren e brendshme të ministrisë. 2. Rregullorja të përfshijë edhe takimet/mbledhjet ndërmjet drejtorive të ministrisë jo vetëm në raste të shqyrtimit të praktikave të përbashkëta por edhe periodikisht (së paku dy herë në vit) për informimin mbi veprimtaritë e drejtorive. 3. Hartimi dhe miratimi i formateve të raportimit periodik të punës së punonjësve të ministrisë. 4. Informimi i stafit të ministrisë për këto formate dhe ruajtja e tyre elektronikisht në një sistem të brendshëm në nivel drejtorie.	1&2. Grup pune me punonjës të ministrisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i dytë 2026. 3&4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026.
19	Analiza vjetore e performancës së institucionit nuk kryhet rregullisht.	Veprimtari	Mesatar	1. Kryerja e analizës vjetore të ministrisë dhe informimi i punonjësve të ministrisë për analizën kryer. 2. Ky detyrim të përfshihet në rregulloren e brendshme të ministrisë.	1.1. Grup pune me punonjës të drejtorive të ministrisë i koordinuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdim. 2. Grup pune me punonjës të ministrisë për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i parë 2026.
20	Përdorimi i memove sqaruese edhe për praktika të thjeshta pune, të tilla si dërgim i shkresave informuese, kthim përgjigje etj., me pasoja në burokratizimin e proceseve të punës.	Veprimtari	Mesatar	1. Kryerja e një vlerësimi të tërësisë së praktikave të punës në ministri. Vlerësimi të analizojë praktikat e punës për të cilat rekomandohet të aplikohet MEMO. 2. Analiza e kryer t'i paraqitet titullarit të ministrisë.	Grup pune me punonjës të ministrisë në koordinimin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore +SP; Gjashtëmujori i dytë 2026.
21	Njohuri të kufizuara të punonjësve të ministrisë për procesin e menaxhimit të rrezikut në të gjitha nivelet e administrimit.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	1. Përfshirja në planin e trajnimeve të ministrisë i trajnimeve, apo seminareve të veçanta për menaxhimin e riskut, me punonjësit që janë ngarkuar me menaxhimin e riskut. 2. Trajnime për riskun e korrupsionit.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me ASPA); Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim. Të gjitha drejtoritë; Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim.



22	Kapacitete teknike të kufizuara në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për vlerësimin e ndikimit rregullator (VNR) të akteve që harton ministria.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	Përfshirja në planin e trajnimeve të ministrisë temave për VNR për stafin e kësaj drejtorie.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me ASPA); Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vijim.
23	1. Veprimtaria e Ekipëve të Menaxhimit të Programeve në ministri nuk është e dokumentuar (procesverbalet e takimeve/mbledhjeve nuk mbahen, nuk kryhet dokumentimi i çështjeve buxhetore të drejtorisë etj.). 2. Kapacitete të kufizuara të punonjësve të Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP) për procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA).	Veprimtari	Mesatar	1. Përcaktimi i një punonjësi në çdo drejtori të ministrisë si sekretariat teknik i EMP-it për drejtorinë përkatëse. 2. Përcaktimi i rregullave për EMP-në në rregulloren e brendshme të ministrisë. 3. Përfshirja në planin e trajnimeve të ministrisë i trajnimeve për anëtarët e EMP-ve për procesin e PBA-së (planifikim, zbatim dhe monitorim).	1. Drejtoritë e ministrisë + SP; Gjashtëmujori parë 2026 dhe në vazhdimësi. 2. Grup pune me punonjës të ministrisë për të hartuar rregulloren e brendshme të ministrisë; Gjashtëmujori i dytë 2026. 3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim.
24	Mungesë e një plan trajnimi për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2020, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.	Veprimtari	Mesatar	Vënie në dijeni dhe nxitje e procesit të hartimit të planit të trajnimit për GMS-në, në Ministrinë e Financës.	Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar +SP; Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim.
25	Përfshirje në komisionet për kryerjen e procedurave të prokurimeve të nëpunësve që nuk janë të pajisur me njohuri dhe aftësi të fushës përgjegjëse që është objekt prokurimi.	Veprimtari	Mesatar	1. Përfshirja në këto komisione për procedurat e prokurimit të specialistëve të fushës përkatëse. 2. Informimi i punonjësve të ministrisë që përfshihen në këto procese pune për legjislacionin dhe procedurat e prokurimit.	1. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar + SP; Gjashtëmujori i parë 2026. 2. Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me Agjencinë e Prokurimit Publik (APP) dhe ASPA-n); Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.
26	Burime njerëzore të pamjaftueshme në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm (DAB) në raport me numrin e subjekteve të identifikuara për auditim. 74 subjekte të identifikuara për auditim.	Veprimtari	Mesatar	1. Plotësimi i vakancave (DAP). 2. Vlerësim i nevojave për burime njerëzore shtesë në këtë drejtori (mbështetur edhe në rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH)). 3. Analiza e nevojave t'i komunikohet titullarit të ministrisë.	1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026. 2&3 Grup pune i koordinuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore Gjashtëmujori i dytë 2026.
27	Zbatimi në praktikë i Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, të pranuar për t'u zbatuar në Shqipëri me urdhrin nr. 103, datë 23.7.2025, të ministrit të Financave, “Për miratimin e Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, të pranuar për zbatim në sektorin publik në RSHP”.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	Zbatimi i procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin nr. 134, datë 17.10.2025, të ministrit të Financave, “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, i cili i shtrin efektet duke filluar nga data 1.1.2026, i shoqëruar me trajnimet e zhvillimit profesional për audituesit e brendshëm.	Drejtoria e Auditit të Brendshëm; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vijimësi .
28	Njohuri teknike të kufizuara të punonjësve të drejtorive të politikave të arsimit të lartë, kërkimit shkencor, arsimit pasuniversitar për përdorimin e sistemeve për hartimin dhe monitorimin e strategjive kombëtare.	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	Përfshirje në planin vjetor të trajnimeve me përdorimin e sistemeve për hartimin dhe monitorimin e zbatimeve të strategjive kombëtare.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me APSA + institucioni përgjegjës); Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdimësi.
29	Vende të lira në burime njerëzore për pozicione pune në: i. Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, me pasoja në efikasitetin e punës dhe	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	1. Nevoja për shpalljen e vendeve të lira, sipas strukturës, për pozicionet e punës në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.	1&2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim.



	arritjen e objektivave të punës së drejtorisë; ii. Drejtorinë e Integritimit, Marrëveshjeve dhe Projekteve për kategorinë e ulët drejtuese.			2. Shpallja e vendeve të lira të pozicioneve të punës sipas strukturës së miratuar për Drejtorinë e Integritimit, Marrëveshjeve dhe Projekteve.	
30	Nevoja për përditësim të njohurive/informacionit për: i. punonjësit e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator për metodologjinë e re të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE).	Burimet Njerëzore/Veprimtari	Mesatar	Përfshirja në planin vjetor të trajnimeve për punonjësit e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator të trajnimeve për metodologjinë e re të PKIE-së.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (bashkërendim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme + ASPA-n); Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim.
31	Burime njerëzore të pamjaftueshme në Drejtorinë e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit të Shërbimeve për kategorinë e ulët drejtuese dhe ekzekutive.	Burimet Njerëzore/Veprimtari	I ulët	1. Shpallja e vendeve të lira të punës sipas strukturës së miratuar për këtë drejtori. 2. Kryerja e një analize për burime njerëzore shtesë në këtë drejtori më qëllim realizimin me efektivitet të detyrave funksionale. 3. Analiza t'i paraqitet titullarit të ministrit.	1, 2 & 3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i dytë 2026.
32	Paqartësi në ndarjen e detyrave ndërmjet drejtorive të ministrisë për punonjësit e angazhuar në VNR.	Veprimtari	Mesatar	Identifikimi brenda ministrisë i grupit të punës që do të përfshihet në proceset e VNR-së dhe përcaktimi i detyrave konkrete për secilin anëtar.	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator + Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar+ SP; Gjashtëmujori i dytë 2026.
33	Njohuri teknike të kufizuara për funksionin e kabinetit në institucion, për kuadrin ligjor dhe rregullator për etikën, konfliktin e interesit dhe integritetin në administratë publike, i anëtarëve të kabinetit të ministrit.	Burimet Njerëzore/Veprimtari	Mesatar	1. Ofrimi i trajnimeve periodike për kuadrin ligjor dhe rregullator për etikën, konfliktin e interesit dhe integritetin në administratë publike me anëtarët e kabinetit (funksionarë politikë). 2. Hartimi i një pakete informuese (akte ligjore dhe nënligjore) për veprimtarinë dhe organizimin e ministrisë, si edhe për detyrat dhe rolin e kabinetit në institucion. 3. Shpërndarja e kësaj pakete për anëtarët e emëruar dhe ata të rinj të kabinetit të ministrit. 4. Kryerja e një trajnimi fillestar për anëtarët e sapoemëruar të kabinetit të ministrit për kuadrin rregullator të veprimtarisë së aparatit të ministrisë dhe administratës publike në tërësi.	1, 2, 3 & 4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkërendim me ASPA/2&3 Drejtoria e Burimeve Njerëzore; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdim rregullisht.
34	Njohuri teknike të kufizuara për stafin e Drejtorisë së Integritimit, Marrëveshjeve dhe Projekteve (stafi i ri) dhe mbi përdorimin dhe fondeve të BE	Burimet Njerëzore/Veprimtari	Mesatar	1. Ofrimi i trajnimeve për punonjësit e ministrisë të përfshirë në procesin e shkrimit të projekteve. 2. Trajnime për përdorimin dhe administrimin e fondeve të BE-së. 3. Trajnime për mashtrimin e përdorimit të fondeve të BE-së.	1,2 & 3. Drejtoria e Burimeve Njerëzore + ASPA; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vijim.
35	Përgjegjësitë dhe detyrat e anëtarëve të kabinetit të ministrit nuk janë të formalizuara sipas funksioneve të ushtruara në kabinet.	Burimet Njerëzore/Veprimtari	Mesatar	1. Të hartohen përshkrime pune për veprimtarinë detyrat dhe përgjegjësitë për anëtarët e kabinetit të ministrit, sipas funksioneve që ata kryejnë. 2. Të publikohen të dhënat e anëtarëve të kabinetit të ministrit	1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Gjashtëmujori i parë 2026 e në vijim. 2. Personi përgjegjës për publikimin në <i>website</i> ; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vijim.

**Objektivi 3: Fusha e transparencës dhe e komunikimit në Ministrinë e Arsimit**

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i riskut/tipi i ndikimit)	Risku i brendshëm	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
36	Nuk është publikuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut Financiar për ministrinë.	Veprimtari	Mesatar	Publikimi në faqen zyrtare të ministrisë i Strategjisë së Menaxhimit të Riskut Financiar	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar + Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori dytë 2026.
37	Baza e të dhënave në format elektronik për vendimet gjyqësore ku ministria është palë duhet përditësuar.	Teknologjia e Informacionit/ Ligjor dhe Kontraktual	Mesatar	Përditësimi dhe publikimi në faqen zyrtare të ministrisë i bazës së të dhënave (në format elektronik) për vendimet gjyqësore dhe detyrimet e krijuara rishtazi, për vitet 2026–2029.	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Gjashtëmujori i dytë 2026.
38	1. Nuk është publikuar akti i Ministrisë të Arsimit për ngritjen e grupit koordinues për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin (SKA) 2027–2032. 2. Nuk janë miratuar planet vjetore të zbatimit të SKA-së.	Veprimtari/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	1. Publikimi i aktit të Ministrisë të Arsimit për ngritjen e grupit koordinues për zbatimin e SKA 2027–2032 në faqen zyrtare të ministrisë/programin e transparencës. 2. Hartimi i planit vjetor për zbatimin të SKA-së dhe publikimi i tyre.	1. Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar + Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i dytë 2022. 2. Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar; Gjashtëmujori i dytë 2026.
39	Baza e të dhënave për lejet dhe licencat e lëshuara nuk janë publikuar në faqen zyrtare të ministrisë.	Teknologji Informacioni/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	1. Përditësimi në mënyrë periodike i bazës së të dhënave në format elektronik për lejet edhe licencat e lëshuara nga kjo ministri dhe publikimi i saj. 2. Përcaktimi i këtij detyrimi në rregullat e drejtorisë.	Drejtoria e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit të Shërbimeve; Gjashtëmujori parë 2026 dhe në vazhdimësi.
40	Baza e të dhënave për të gjitha marrëveshjet ku ministria është palë nuk është publikuar në faqen e ministrisë.	Teknologjia e Informacionit/ Informacioni	Mesatar	Publikimi i bazës së të dhënave të përditësuara për marrëveshjet, memorandumet bashkëpunimi etj. të lidhura nga ministria.	Drejtoria e Integritetit, Marrëveshjeve dhe Projekteve + Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i dytë 2026.
41	Mungesë e publikimit të të dhënave statistikore në faqen e internetit të ministrisë.	Teknologjia e Informacionit/ Informacioni	I ulët	Publikimi i të dhënave statistikore në faqen e internetit të ministrisë.	Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave + Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.
42	Mungesa e formateve për vërtetimin e dorëzimit të kërkesave të publikut në ministri.	Veprimtari	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i formateve për vërtetimin e dorëzimit të ankesave/kërkesave të publikut në ministri.	Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi;
43	Nuk është publikuar lista e ekspertëve të jashtëm të angazhuar në procesin e licencimit.	Teknologjia e Informacionit/ Informacioni	Mesatar	Përpilimi i një liste të ekspertëve që angazhohen në vlerësimin e programeve në procesin e licencimit dhe publikimi i saj në faqen zyrtare të ministrisë.	Drejtoria e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit të Shërbimeve Koordinatorit për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.
44	Njohuri të kufizuara të punonjësve të ministrisë për të drejtën e informimit dhe kufizimet e saj, menaxhimin e të dhënave, publikimin dhe formatet e të dhënave të hapura.	Burime Njerëzore	Mesatar	Ofrimi i trajnimeve për punonjësit e ministrisë për të drejtën e informimit dhe kufizimet e saj, menaxhimin e të dhënave, publikimin dhe formatet e hapura të të dhënave.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore (në bashkërendim me ASPA-n + Komisionerin për të Drejtën e Informimit); Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.



Objektivi 4: *Mjedisi i brendshëm rregullator dhe i politikave të fushës për të promovuar integritetin, llogaridhënien dhe parandaluar korrupsionin në fushën e arsimit*

4.1 Fusha e Politikave dhe Programeve të Zhvillimit të Arsimit					
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i riskut/tipi i ndikimit)	Risku i brendshëm	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
45	Nuk është miratuar plani vjetor i zbatimit të SKA-së.	Veprimtari/Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	1. Hartimi i planit vjetor për zbatimin e SKA-së 2. Publikimi i tij.	1&2. Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor + Koordinator për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vijim. 1&2. Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor; Gjashtëmujori i dytë 2026.
46	Mbledhja e kontributeve të raporteve vjetore të monitorimit për zbatimin e Strategjisë së Kërkimit Shkencor.	Veprimtari/Reputacioni dhe Imazhi	I ulët	1. Hartimi i raportit vjetor të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKKSHTI) 2023–2030. 2. Konsultimi i raportit vjetor me aktorët e interesuar të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve të tjera apo organizatave të shoqëria civile etj. 3. Publikimi i raporteve të monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (SKKSHTI) 2023–2030.	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor + Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik + Koordinator për të Drejtën e Informimit; Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vijim.
47	Mungon vlerësimi për eficiencën e procesit të shpërndarjes së teksteve shkollore për arsimin parauniversitar (APU) në institucionet arsimore.	Veprimtari	Mesatar	1. Ngritja e një grupi pune me punonjës të ministrisë, institucioneve të varësisë që operojnë në fushën e arsimit parauniversitar, përfaqësues të aktorëve të interesit si edhe ekspertë të pavarur të fushës me qëllim vlerësimin për rishikimin e politikës së shpërndarjes së teksteve shkollore të APU në institucione arsimore. 2. Analiza për vlerësimin për rishikimin e politikës së shpërndarjes së teksteve shkollore të APU në institucione arsimore hartuar. 3. Analiza finale t'i paraqitet titullarit të ministrisë.	1, 2 & 3. Grup pune me punonjës i koordinuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar + SP Gjashtëmujori i dytë 2026
48	Vonesa në nxjerrjen e tërësisë së akteve nënligjore në zbatim të ligjit “Për arsimin e lartë” (LAL).	Veprimtari	Mesatar	1. Kryerja e një verifikimi i të gjitha akteve nënligjore të që nuk janë hartuar në zbatim të LAL (analizë vlerësimi). 2. Hartimi i një plani veprimi me afate konkrete për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore që mungojnë. 3. Kryerja e një analize për aktet nënligjore që paraqesin vështirësi në hartimin e tyre dhe dhënia e rekomandimeve konkrete për ndryshime të mundshme të Ligjit të Arsimit të Lartë.	1, 2 & 3. Grup pune me punonjës nga Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor + SP; 2026 dhe në vijim.
49	Mungesë financimesh për realizimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor në LAL.	Veprimtari	Mesatar	1. Kryerja e një analize financiare për parashikimin e një fondi real buxhetor për nevojat e kërkimit shkencor në AL në vend. 2. Konsultim i analizës me grupe të interesuar (partnerë)	1. Grup pune i formuar me punonjës të Drejtorisë së Politikave të AL + Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Gjashtëmujori I 2026.



				2. Analiza t'i paraqitet titullarit të ministrisë.	
50	Nevoja për të optimizuar dokumentin e kontributeve të marra gjatë konsultimeve publike, me qëllim rritjen e transparencës dhe gjurmueshmërisë së reflektimit të tyre në dokumentet finale.	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar	I ulët	Standardizim i procesverbaleve të konsultimit dhe të hartimit të raporteve përmbljedhëse mbi trajtimin e sugjerimeve të palëve të interesuara.	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar; 2026 e në vijim.
51	ASCAL-i nuk është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (nuk i nënshtrohet konkurrencës me agjenci publike që operojnë në rrafshin evropian).	Burimet Njerëzore/ Veprimtari	Mesatar	1. Vlerësimi i procesit të anëtarësimit dhe i mundësive reale të ASCAL për anëtarësim të plotë në Shoqatën Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. 2. Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi me këtë qëllim, duke parashikuar aktivitete konkrete dhe afate përkatëse. 3. Zbatimi i planit të veprimit.	1, 2&3. Grup pune i formuar me punonjës nga Drejtoria e Programeve të Arsimit të Lartë + ASCAL + SP; Gjashtëmujori i parë 2026.
52	1. Identifikimin e nevojave për projekte në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor; 2. Shkëmbimin e informacionit sipas fushave përkatëse për hartimin e strategjive apo raporteve të monitorimit.	Veprimtari	Mesatar	1. Realizimi i takimeve periodike ndërmjet Drejtorisë së Integritit, Marrëveshjeve dhe Projekteve me drejtoritë e politikave në ministri edhe institucionet e varësisë me qëllim: a) identifikimin e nevojave për projekte në fushat e përgjegjësisë; dhe b) shkëmbimin e informacionit procesin e hartimit dhe monitorimit të strategjive. 2. Organizimi i tryezave të punës me përfaqësues të IAL-ve për identifikimin e nevojave dhe problematikave gjatë zbatimit të projekteve të ndryshme në këto fusha.	Drejtoria e Integritit, Marrëveshjeve dhe Projekteve + Drejtoritë e Politikave +SP; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.

4.2 Fusha e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i rrezikut/ tipi i impaktit)	Risku inherent	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve
53	Vonesa në dërgimin e kontributeve nga drejtoritë e ministrisë dhe institucionet e varësisë në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator për trajtimin e praktikave të përbashkëta të punës, veçanërisht në dhënie të mendimeve për projektaktet e paraqitur për mendim nga ministritë.	Veprimtari	Mesatar	1. Hartimi i rregullave të qarta për mënyrën e komunikimit mes drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë dhe vendosja e afateve konkrete për dërgimin e informacioneve/kontributeve në trajtimin e praktikave të përbashkëta. 2. Këto rregulla të parashikohen në rregulloren e brendshme të ministrisë.	1&2. Grup pune me punonjës nga drejtoritë në ministri në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore për hartimin e rregullores së re të ministrisë; Gjashtëmujori dytë 2026.

4.3 Fusha e Lejeve, licencave dhe monitorimit të shërbimeve

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i rrezikut/ tipi i ndikimit)	Risku i brendshëm	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
54	Mungesa e një PSV të brendshme për procesin e licencimit të IAL-ve dhe institucioneve arsimore në ministri.	Veprimtari	Mesatar	Hartimi dhe miratimi i një PSV-je të brendshme për procesin e licencimit brenda ministrisë.	Grup pune me punonjës të drejtorive të ministrisë i në bashkëpunim me Drejtorinë e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit të Shërbimeve; Gjashtëmujori i parë 2026.



55	Vonesa në procesin e vlerësimit të aplikimeve në kuadër të licencimit, apo dhënies së lejeve.	Veprimtari	Mesatar	1. Kryerja e një analize mbi efikasitetin e procesit të licencimit nëpërmjet grupeve punës me punonjës të ministrisë për vlerësimin e aplikimeve, me qëllim shmangien e burokratizimit të procesit. 2. Analiza t'i paraqitet titullarit të ministrisë.	1& Grup pune me punonjës të drejtorive të ministrisë i në bashkëpunim me Drejtorinë e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit të Shërbimeve; Gjashtëmujori i parë 2026.
56	Mungesa e ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e programe të veçanta të studimit.	Burimet Njerëzore/Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	1. Kryerja e një vlerësimi të nevojave dhe të mungesave për ekspertë të jashtëm në vlerësimin e programeve të veçanta të studimit. 2. Konsultim me IAL-të, institucionet që veprojnë në fushën e arsimit dhe aktorë të interesuar në fushë. 3. Nisja e një procedure për shpalljen e kërkesave për ekspertë në programe që paraqesin mungesë ekspertize për vlerësimin e programeve të studimit në faqen zyrtare të ministrisë.	1, 2 & 3. Drejtoria e Lejeve, Licencave dhe Monitorimit + DALKSH + SP Gjashtëmujori dytë 2026.

4.4. Fusha e jetësimit të prioritetëve dhe statistikave

Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (burimi i riskut/tipi i ndikimit)	Risku i brendshëm	Plani i masave	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për realizimin e aktiviteteve
57	Mungesë e një metodologjie që përcakton përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave/informacionit statistikor me synimin e përpunimit informacionit në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor.	Veprimtari	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i një metodologjie që përcakton përdorimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor të politikave arsimore dhe kërkimit shkencor. 2. Të dhënat statistikore që përpunohen nga Drejtoria e Jetësimit të Prioritetëve dhe Statistikave të ndahen me drejtoritë e tjera të ministrisë në mënyrë periodike. 3. Identifikimi i të dhënave statistikore për publikim dhe publikimi i të dhënave statistikore.	1. Drejtoria e Jetësimit të Prioritetëve dhe Statistikave; Gjashtëmujori i dytë 2026. 2&3 Drejtoria e Jetësimit të Prioritetëve dhe Statistikave; Gjashtëmujori i parë 2026 dhe në vazhdimësi.
58	Vonesa në mbledhjen e informacionit, të dhënave statistikore për shkak të mungesës së stafit.	Veprimtari	Mesatar	1. Komunikim periodik me IAL-të në kuadër të raportimit prej tyre të të dhënave që gjenerojnë. 2. Përgatitja e raporteve periodike në informimin korrekt i strukturave.	Drejtoria e Jetësimit të Prioritetëve dhe Statistikave; Gjashtëmujori i dytë 2026 dhe në vazhdimësi.

URDHËR

Nr. 466, datë 29.4.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*



7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
9.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
11.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulęcín	Krzyszczewo*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Błotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chelmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Zuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Lódzkie	Poddębice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Słupsk	Kobylnica*
29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Malomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdanice*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemien*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wohryn*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzecz Podlaski (rural)*
36.	Podlaskie	Hajnówka	Narew*
37.	Mazowieckie	Mława	Szydłowo*
38.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
39.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Ostrów Wielkopolski (rural)*
40.	Lubuskie	Gorzów	Lubiszyn*
41.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
42.	Wielkopolskie	Turek	Brudzew*
43.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
44.	Pomorskie	Kartuzy	Sulęcino*
45.	Wielkopolskie	Srem	Brodnica*
46.	Śląskie	Pszczyna	Pszczyna*
47.	Wielkopolskie	Turek	Władysławów*
48.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Rogowo*
49.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
50.	Zachodniopomorskie	Stargard	Dobrzyń*
51.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
52.	Dolnośląskie	Lęgnica	Prochowice*
53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Gnibów Nad Prosną*
54.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
55.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Janikowo*
56.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
57.	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
58.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Kruszwica*
59.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Lwówek*
60.	Wielkopolskie	Leszno	Włoszakowice*
61.	Lódzkie	Brzeziny	Jeżów*
62.	Mazowieckie	Zuromin	Bieżuń*
63.	Mazowieckie	Zuromin	Zuromin*
64.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
65.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
66.	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
67.	Mazowieckie	Mława	Strzegowo*
68.	Mazowieckie	Zuromin	Kuczbork-Osada*
69.	Mazowieckie	Mława	Szeńsk*
70.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
71.	Mazowieckie	Płońsk	Baboszewo*
72.	Wielkopolskie	Kalisz	Brzeziny*
73.	Pomorskie	Starogard	Skarszewo*
74.	Mazowieckie	Mława	Stupsk*
75.	Lubuskie	Zary	Zary*
76.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
77.	Kujawsko-Pomorskie	Golub-Dobrzyń	Kowalewo Pomorskie*
78.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*

Sënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 431, datë 21.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



URDHËR

Nr. 467, datë 29.4.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Malopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Lapy*

6.	Malopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8.	Malopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tuszczy*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Malopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miłoradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wąjewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51.	Malopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszyniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytów*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*



67.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyń*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79.	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80.	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Górnica*
81.	Lubuskie	Nowa Sól	Kozuchów*
82.	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83.	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84.	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85.	Śląskie	Mikolów	Mikolów*
86.	Mazowieckie	Mława	Szeńsk*
87.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Aleksandrów Kujawski (rural)*
88.	Lubuskie	Sulęcín	Krzyszczewo*
89.	Łódzkie	Sieradz	Wróblew*
90.	Opolskie	Olesno	Zębowice*
91.	Małopolskie	Wieliczka	Wieliczka*
92.	Śląskie	Cieszyn	Hażlach*

Shtënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të

shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 449, datë 27.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR

Nr. 469, datë 30.4.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.



2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
9.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
11.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulęcín	Krzeszyce*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Błotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chełmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Zuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Łódzkie	Podębice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Słupsk	Kobylnica*
29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Malomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemień*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wołyń*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)*
36.	Podlaskie	Hajnówka	Narew*
37.	Mazowieckie	Mława	Szydłowo*
38.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
39.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Ostrów Wielkopolski (rural)*
40.	Lubuskie	Gorzów	Lubiszyn*
41.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
42.	Wielkopolskie	Turek	Brudzew*
43.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
44.	Pomorskie	Kartuzy	Sulęcyno*
45.	Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
46.	Śląskie	Pszczyna	Pszczyna*
47.	Wielkopolskie	Turek	Władysławów*
48.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Rogowo*
49.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
50.	Zachodniopomorskie	Stargard	Dobrzany*
51.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
52.	Dolnośląskie	Legnica	Prochowice*
53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Grabów Nad Prosną*
54.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*

55.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Janikowo*
56.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
57.	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
58.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Kruszwica*
59.	Wielkopolskie	Nowy Tomysł	Lwówek*
60.	Wielkopolskie	Leszno	Włoszakowice*
61.	Łódzkie	Brzeziny	Jeżów*
62.	Mazowieckie	Zuromin	Bieżeń*
63.	Mazowieckie	Zuromin	Zuromin*
64.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
65.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
66.	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
67.	Mazowieckie	Mława	Strzegowo*
68.	Mazowieckie	Zuromin	Kuczbork-Osada*
69.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
70.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
71.	Mazowieckie	Płońsk	Baboszewo*
72.	Wielkopolskie	Kalisz	Brzeziny*
73.	Pomorskie	Starogard	Skarszewy*
74.	Mazowieckie	Mława	Stupsk*
75.	Lubuskie	Żary	Żary*
76.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
77.	Kujawsko-Pomorskie	Golub-Dobrzyń	Kowalewo Pomorskie*
78.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
79.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Nowe Miasto Lubawskie (rural)*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.



7. Urdhri nr. 466, datë 29.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 470, datë 30.4.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën

e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produkteve të mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15	Mazowieckie	Wolomin	Źłuszcz*
16	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31	Podlaskie	Mońki	Goniadz*
32	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*



46	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50	Wielkopolskie	Nowy Tomysł	Opalenica*
51	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53	Wielkopolskie	Szamotuly	Duszyniki*
54	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Byton*
60	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzężmnik*
62	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osiężyn*
65	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
67	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyna*
72	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74	Wielkopolskie	Szamotuly	Kaźmierz*
75	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
76	Mazowieckie	Plock (City)	Plock*
77	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Dąbrowa Górnicza*
81	Lubuskie	Nowa Sól	Kożuchów*
82	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85	Śląskie	Mikolów	Mikolów*
86	Mazowieckie	Mława	Szeńsk*
87	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Aleksandrów Kujawski (rural)*
88	Lubuskie	Sulęcín	Krzyszczewo*
89	Łódzkie	Sieradz	Wróblew*
90	Opolskie	Olesno	Zębowice*
91	Małopolskie	Wieliczka	Wieliczka*
92	Śląskie	Cieszyn	Hażlach*
93	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë të cilat nuk

kanë pasur njohim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 467, datë 29.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



VENDIM

Nr. 26, datë 9.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Asim Vokshi,	anëtar;
Genti Ibrahimimi,	anëtar,

me sekretare Farijsa Idrizaj, në datën 24.2.2026,
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 9 (E) 2025 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Edmond Hysenaj, përfaqësuar nga
avokati Arnton Kasaj, me prokurë të përgjithshme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Prokuroria e
Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Isa Jata.

Hamlet Hysenaj, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-
1923 (290), datë 21.11.2024, të Kolegjit Penal të
Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën
e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 41, 42, 131, pika 1,
shkronja “F”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika
2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
(*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të
Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji
nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe
funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës
së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi,
mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të
kërkuesit Edmond Hysenaj (*kërkuesi*), i cili ka
kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim
të subjektit të interesuar, Prokurorisë së
Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës,
konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të
subjektit të interesuar Hamlet Hysenaj, si dhe
diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi dhe dy vëllezërit e tij janë
trashëgimtarë të shtetasit M. H., të cilit, me
vendimin nr. 75, datë 21.3.1995, të Komisionit të
Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Vlorë
(KKKP) (*vendimi nr. 75/1995*), i është njohur e
drejta e pronësisë për një sipërfaqe truall prej
3.600 m², të ndodhur në zonën e “Ujit të Ftohtë”,
Vlorë. Prona është regjistruar rregullisht në Zyrën
e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë
(ZRPP) në emër të kërkuesit dhe vëllezërve të tij
me 1/3-ën pjesë secili.

2. Si pronarë të pasurisë truall të sipërpërmendur
kërkuesi dhe vëllezërit e tij kanë lidhur kontratë
sipërmarrjeje me një shoqëri ndërtimi, mbi bazën e
së cilës (kontratës së sipërmarrjes), Këshilli i
Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë së Vlorës, në
nëntor të vitit 2010, ka miratuar në favor të
shoqërisë lejen e ndërtimit për një objekt banimi.

3. Në datën 14.11.2024, shtetasi Hamlet Hysenaj
(*kallëzuesi*) ka paraqitur kallëzim penal në
Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Vlorë (*Prokuroria e Vlorës*), me pretendimin se në
përfitim të kësaj prone shtetasi M. H. ka përdorur
dokumente të falsifikuara, pasi në regjistrat e
pasurive të paluajtshme ajo ka qenë e regjistruar në
emër të babait të tij, F. H. dhe jo në emër të shtetasit
M. H., në lidhje gjinie me të.

4. Mbi bazën e këtij kallëzimi, Prokuroria e
Vlorës ka regjistruar procedimin penal për veprën
penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar
nga neni 186 i Kodit Penal (KP) dhe, në funksion të
hetimit, ka sekuestruar në ZRPP-në, Vlorë të gjithë
praktikën e regjistrimit të pasurisë, për të cilën është
disponuar me vendimin nr. 75/1995 të KKKP-së,
Vlorë.

5. Në përfundim të veprimeve hetimore, me
vendimin e datës 28.12.2016, Prokuroria e Vlorës ka
pushuar procedimin penal, megjithëse ka arritur në
përfundimin se pasuria e regjistruar në favor të
trashëgimtarëve të M. H. është produkt i veprës
penale “Falsifikimi i dokumenteve”, pasi nuk
provohet dijenia e trashëgimtarëve të M. H. se
pasuria në fjalë, të cilën e kanë regjistruar dhe
disponuar, është produkt i veprimtarisë kriminale.
Ndërkohë, prokuroria ka përcaktuar se, në aplikim



të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dokumentet e sekuestruara në ZVRPP-në, Vlorë, ndër të tjera, vendimi nr. 75/1995 i KKKP-së, Vlorë (kopje e njëzuar me origjinalin), planvendosjet përkatëse, praktika e regjistrimit të pasurisë në emër të bashkëpronarëve Hysenaj etj., do të qëndrojnë në fashikullin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e tij si për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ashtu edhe për sa i përket disponimit për dokumentacionin e sekuestruar.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 616, datë 6.12.2018, ka vendosur rrëzimin e ankimit, duke lënë në fuqi vendimin e Prokurorisë së Vlorës, datë 28.12.2016, për pushimin e çështjes penale.

7. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 42, datë 29.1.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe të vendimit të Prokurorisë së Vlorës për shkakun e pushimit, duke vlerësuar se, në rastin konkret, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Po kështu, ajo ka disponuar edhe për kthimin e dokumenteve të sekuestruara në institucionet ose subjektet ku janë sekuestruar. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kallëzuesi Hamlet Hysenaj.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1923 (290), datë 21.11.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit, duke vlerësuar se gjykata e apelit nuk ka argumentuar mjaftueshëm se përse përfundimet e organit të akuzës, të mbështetura më pas edhe nga gjykata e rrethit, nuk qëndrojnë.

9. Në datën 11.4.2025, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ndërsa, në datën 25.6.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmblëdhur, ka pretenduar se Gjykata e Lartë i ka cenuar:

10.1 *Të drejtën për proces të rregullt*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi ka dhënë një vendim tej shkaqeve të parashikuara nga neni 432, pika 1, i KPP-së, duke bërë një përcaktim të ndryshëm të fakteve nga përcaktimi i bërë nga gjykata e apelit.

10.1.2 *Së drejtës së aksesit* të lidhur me *të drejtën e mbrojtjes efektive* dhe me *parimin e barazisë së armëve*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar rekursin e plotë të ushtruar nga personi i interesuar Hamlet Hysenaj, vendimin e saj për konstatimin me të meta të rekursit, si dhe aktin për plotësimin e këtyre të metave. Në këto kushte, kërkuesi ka qenë në padijeni të plotë të shkaqeve të rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit.

10.1.3 *Parimit të sigurisë juridike*, për shkak se Gjykata e Lartë ka kryer një proces të nisur me rekurs të një subjekti që nuk ka legjitimitet aktiv të kundërshtojë vendimin e pushimit penal, pasi nuk është “i dëmtuar” nga fakti i hetuar.

10.1.4 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe bie në kundërshtim me nenin 383 të KPP-së. Pjesët e tij përbërëse bien në kundërshtim me njëra-tjetrën dhe konkluzionet e Kolegjit Penal janë mbështetur në citimin e gabuar të vendimit të gjykatës së apelit objekt rekursi, duke e bërë vendimin kontradiktor.

10.2 *Të drejtën e pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në aspektin substancial dhe procedural, pasi sekuestrimi i dokumentacionit origjinal të pronës pa një proces të rregullt ligjor e ka penguar ta disponojë atë lirisht, pa qenë i anuluar ose i shfuqizuar vendimi, mbi bazën e të cilit i ka lindur e drejta për të ushtruar tagrat e pronësisë, sipas nenit 149 të Kodit Civil, në cenim edhe të *parimit të sigurisë juridike*.

11. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar se:

11.1 Pretendimet e kërkuesit për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar brenda funksionit të saj, në vlerësimin juridik të çështjes.

11.2 Pretendimet për cenimin e *së drejtës së aksesit* të lidhur me *të drejtën e mbrojtjes efektive* dhe *parimin e barazisë së armëve* janë të pabazuara, pasi kërkuesi është njoftuar rregullisht si për depozitimin e rekursit (rekurs i shkurtuar), ashtu edhe për datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë.

11.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të subjektit të



interesuar Hamlet Hysenaj, i cili, si kallëzues penal dhe person i dëmtuar nga veprimi penal i falsifikimit të dokumenteve të pronësisë, ka interes të ligjshëm për të ndjekur çështjen konkrete.

11.4 Pretendimi për *cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi vendimi i Kolegjit Penal përmban elementet kryesore të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nuk përmban kundërthënie të tilla që do ta bënë atë të papajtueshëm me kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës.

11.5 Pretendimi për *cenimin e së drejtës së pronës private* është i pabazuar, pasi organi i akuzës ka vepruar në interes publik, për mbrojtjen e sigurisë së transaksioneve juridike dhe besimit të dokumentet zyrtare, objektiv që justifikon çdo kufizim të së drejtës së pronësisë. Kufizimi i së drejtës së pronës është bërë përmes vendimmarrjes së organit të akuzës, e cila është vlerësuar si e drejtë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Gjykata, për sa i takon kriterit për legjitimitimin *ratione personae*, ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës individi është subjekt i kushtëzuar. Si i tillë, ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një

shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuari duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*sib vendimet nr. 64, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuari ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë, në aspektin procedural, e justifikon interesin e tij për kundërshtimin e procesit në fjalë. Ndërsa për sa i përket aspektit substancial, Gjykata evidenton se kërkuari ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor për kundërshtimin e vendimit të prokurorit që, ndërsa ka pushuar procedimin penal me arsyetimin se nuk provohet dijenia e kërkuarit dhe e trashëgimtarëve të tjerë të M. H. se pasuria e regjistruar dhe e disponuar prej tyre është produkt i veprimtarisë kriminale, ka disponuar me sekuestrimin e të gjithë praktikës së regjistrimit të kësaj pasurie në ZVRPP, Vlorë. Vendimi i gjykatës së rrethit që ka rrëzuar ankimin e tij është ndryshuar nga gjykata e apelit, e cila ka disponuar edhe për kthimin e dokumenteve të sekuestruara në institucionet përkatëse, kurse Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e kësaj të fundit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

15. Gjykata vëren se, edhe pse objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të dhëna gjatë procesit për kundërshtimin e veprimeve të prokurorit, në thelb, e drejta substancial që synohet të mbrohet nga kërkuari është ajo e pronës, e cenuar, sipas tij, si pasojë e sekuestrimit të praktikës së regjistrimit të vendimit nr. 75/1995 të KKKP-së, Vlorë nga organi i akuzës. Në këtë situatë, duke pasur parasysh qëllimin e procesit të vënë në lëvizje nga kërkuari, që është mbrojtja e së drejtës së pronës në drejtim të së drejtës së disponimit të lirë të saj, si dhe se rivendosja në vend e kësaj të drejte është e ndërlikuar me përfundimin e procesit objekt ankimi kushtetues individual, Gjykata vlerëson se kërkuari e plotëson kriterin e legjitimitimit *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës edhe në aspektin substancial.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, sipas të cilit individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave



kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë (*shih vendimet nr. 61, datë 19.9.2024; nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në ankimin kushtetues individual kërkuksi ka pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, duke parashtruar si shkak se Gjykata e Lartë ka shqyrtuar rekursin e subjektit të interesuar Hamlet Hysenaj, i cili nuk kishte legjitimitet aktiv. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, e ka prapësuar si të pabazuar këtë pretendim, me argumentin se ky subjekt ka pasur interes të ligjshëm për çështjen si kallëzues penal dhe person i dëmtuar nga falsifikimi i dokumenteve të pronësisë.

18. Për sa i takon këtij pretendimi, nga materialet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata eidenton se subjekti i interesuar Hamlet Hysenaj, njëkohësisht kallëzues i veprës penale, është thirrur në gjykim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me cilësinë e personit të interesuar, duke marrë për këtë qëllim paraprakisht edhe mendimet e prokurorit dhe të avokatit të kërkuksit. Ky i fundit është shprehur dakord për thirrjen në gjykim të këtij shtetasi (*shih procesverbalin e seancës, datë 29.10.2018*) dhe nuk rezulton të ketë ngritur pretendime në këtë drejtim në ankimin drejtuar gjykatës së apelit. Në këto kushte, pavarësisht se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike ngrihet ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se ai nuk rezulton të jetë parashtruar më parë në gjykatat e faktit, për rrjedhojë vlerëson se në lidhje me të kërkuksi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës. Ndërsa, për sa u përket pretendimeve të tjera, kërkuksi nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

19. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual, i është njoftuar në rrugë elektronike, përmes mbrojtësit, në datën 21.1.2025, ndërsa

kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 11.4.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, kërkuksi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt* në drejtim të *së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, si dhe *së drejtës së pronës*, të garantuara nga nenet 42, 142 dhe 41 të Kushtetutës.

21. Për sa u takon argumenteve në thelb të këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se ato parashtrohen në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosnjohimit të kërkuksit për rekursin e plotë të shtetasit Hamlet Hysenaj, si dhe së drejtës së pronës, si pasojë e qëndrimit të Gjykatës së Lartë për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit që ka pranuar disponimin e Prokurorisë Vlorë për sekuestrimin e akteve të fitimit të pronësisë.

22. Gjykata sjell në vëmendje paraprakisht se nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë rezulton se vendimi nr. 75/1995 të KKKP-së, Vlorë është bërë objekt gjykimi në një tjetër proces civil, me objekt anulimin tërësisht të tij, e njohjen pronarë të trashëgimtarëve ligjorë të shtetasit F.H., dhe çështja rezulton të jetë kthyer për shqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Pavarësisht këtij fakti, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës e drejta e pronës realizohet përmes ushtrimit të tre tagrave të pronësisë, konkretisht së drejtës së posedimit, së drejtës së gëzimit dhe së drejtës së disponimit (*shih vendimin nr. 53, datë 31.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*), faktin se veprimet e Prokurorisë Vlorë dhe vendimmarrja e Gjykatës së Lartë kanë ndikuar në tagrin e kërkuksit për disponimin e lirë të pronës së tij, si dhe në parashikimet e nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit e drejta e pronës private nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen kësaj të drejte, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, Gjykata çmon t'i trajtojë pretendimet e kërkuksit në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes

23. Kërkuksi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar rekursin e plotë të ushtruar nga personi i interesuar Hamlet Hysenaj, vendimin e saj për konstatimin me të meta të rekursit, si dhe aktin për plotësimin e këtyre të metave, duke i hequr mundësinë për të paraqitur kundërrekurs. Po



kështu, ai ka qenë në padijeni të plotë të shkaqeve të rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit, si dhe të procedurave të ndjekura nga Gjykata e Lartë.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, i ka prapësuar si të pabazuara këto pretendime, me argumentin se kërkuesi është njoftuar rregullisht si për depozitimin e rekursit (rekurs i shkurtuar), ashtu edhe për seancën e caktuar në dhomën e këshillimit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

25. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 56, datë 10.10.2025; nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 14, datë 21.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar se disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, për situatat kur pretendohet mosnjoftimi i rekursit, Gjykata ka theksuar se njoftimi i akteve me të cilat vihet në lëvizje një proces gjyqësor ka rëndësi në drejtim të pjesëmarrjes së individit në gjykim dhe të realizimit të të drejtave të tij kushtetuese. Njoftimi i akteve gjyqësore në kohën e duhur përbën një garanci të domosdoshme si për të vënë në dijeni individin për procesin gjyqësor ku ai është palë, ashtu edhe për të garantuar pjesëmarrjen e tij në proces dhe ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes dhe përdorimit e mjeteve procedurale në funksion të mbrojtjes së tij, siç është kundërrekursi ose prapësimet ndaj pretendimeve të palës tjetër në proces (*shih vendimin nr. 41, datë 29.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, duhet

t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato, ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen. Ajo ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimin e barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 32, datë 23.4.2024; nr. 41, datë 18.9.2023; nr. 16, datë 8.6.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht vendimin e prokurorisë për pushimin e procedimit penal, i cili është lënë në fuqi nga gjykata e rrethit, ndërsa është prishur nga gjykata e apelit, vendimi i së cilës është kundërshtuar me rekurs të shkurtuar nga Hamlet Hysenaj. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues rezulton se rekursi i shkurtuar i është komunikuar kërkuesit në datën 5.4.2019. Në këtë mjet procedural është parashtruar vetëm kundërshtimi i vendimit të gjykatës së apelit (numër e datë) dhe lidhur me shkaqet ligjore është njoftuar se ato do të parashtrohen pas njohjes me vendimin e arsyetuar të gjykatës. Pas arsyetimit të vendimit të plotë nga Gjykata e Apelit Vlorë, në datën 16.4.2019, Hamlet Hysenaj ka depozituar rekursin e plotë, i cili, për shkak të mosnënshkrimit të tij nga avokati, sipas kërkesave të nenit 435, pika 2, të KPP-së, është kthyer nga Gjykata e Lartë për plotësimin e kësaj të mete. Në vijim, Hamlet Hysenaj ka depozituar rekursin e plotësuar sipas parashikimit ligjor dhe çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë. Rekursi me shkaqet e plota, i cili përmban argumente se përse vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset, i është komunikuar vetëm Prokurorisë së Vlorës më 30.4.2019 dhe nuk rezulton t'i jetë komunikuar kërkuesit ose avokatit të zgjedhur prej tij.

28. Gjykata vëren gjithashtu se sipas nenit 414 të KPP-së, në fuqi në kohën e depozitimit të rekursit nga shtetasi Hamlet Hysenaj, sekretaria e gjykatës që ka dhënë vendimin ka pasur detyrimin për t'ua komunikuar atë prokurorit, të pandehurit dhe palëve private.

29. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata evidenton se, sipas të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, në datën 14.10.2024, është publikuar lista e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit në datën 21.11.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit. Po kështu, referuar akteve të dosjes



gjyqësore rezulton se avokati i kërkuesit është njoftuar nga sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Lartë përmes postës elektronike për zhvillimin e seancës, në dhomën e këshillimit, në datën 21.11.2024, ora 9:20, ndërkohë që nuk rezulton të ketë paraqitur pretendime. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancën e datës 21.11.2024, Kolegji Penal ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

30. Nga sa më lart, Gjykata vëren se kërkuesi nuk rezulton të jetë njoftuar as personalisht, as nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur për rekursin e plotë të kallëzuesit. Për më tepër, Gjykata e Lartë nuk e ka konstatuar këtë fakt gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit dhe nuk ka arsyetuar nëse në rastin konkret ishin përmbushur detyrimet e nenit 414 të KPP-së. Ndonëse në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kjo e fundit, përmes administratës gjyqësore, ka kryer njoftimin e datës së zhvillimit të seancës gjyqësore në përputhje me parashikimet procedurale të zbatueshme në atë gjykim, duket se kjo nuk është e mjaftueshme për të korrigjuar dhe riparuar të metat e evidentuara në drejtim të njoftimit të rekursit, të cilat sjellin si pasojë humbjen nga ana e kërkuesit të së drejtës për të paraqitur argumente ligjore në kundërshtim të pretendimeve të palës rekursuese, si dhe parashtrimin e qëndrimit dhe të pretendimeve të tij për zgjidhjen e çështjes. Po kështu, kjo mangësi nuk duket të jetë riparuar nga Gjykata e Lartë, pasi ajo nuk ka verifikuar paraprakisht nëse rekursi me shkaqet e plota i ishte njoftuar kërkuesit ose përfaqësuesit të zgjedhur prej tij në të dyja shkallët e gjykimit, për më tepër që përmes rekursit kundërshtohet vendimi i gjykatës së apelit që kishte disponuar në favor të kërkuesit.

31. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës aksesit dhe së drejtës për t'u mbrojtur është i bazuar.

32. Në kushtet kur sa më lart, Gjykata ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për procesin e zhvilluar nga Gjykata e Lartë janë të bazuara, çmon të mos ndalet në analizën e pretendimit të kërkuesit për cenimin e të drejtës së pronës (*shih paragrafët 21–22 të vendimit*), për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, duhet t'i japë përgjigje të arsyetuar këtij pretendimi.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

33. Në datën 23.2.2026, përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për mbulimin e shpenzimeve të gjykimit kushtetues të çështjes. Sipas kërkuesit, mbrojtja juridike ka qenë e domosdoshme, për shkak të kompleksitetit të çështjes, natyrës së saj, kohëzgjatjes, materialit voluminoz që i është dashur për të përgatitur kërkesën. Për këtë qëllim, kërkuesi ka paraqitur faturën e datës 20.2.2026, të lëshuar nga avokati Arifton Kasaj, në vlerën 100.000 lekë (pa TVSH), të përshkruar si pagesë për ofrimin e shërbimit të përgatitjes së ankimit kushtetues individual.

34. Gjykata vëren se në nenin 28 të Ligjit Organik të Gjykatës janë parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (pika 1); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (pika 2). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (pika 2); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 4).

35. Gjykata vëren se referuar përmbajtjes së dispozitave si më sipër, së pari, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, së dyti, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Në rastin konkret, kërkesa për shpenzimet gjyqësore është paraqitur përpara zhvillimit të seancës plenare.

36. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, në parim, çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit kushtetues individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Individi ka të drejtën e mbulimit të



shpenzimeve vetëm nëse vërtetohet se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblyerit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore” (*udhëzimi nr. 18/2020*), shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50.000 lekë dhe 60.000 lekë, ndërsa për shërbime juridike jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25.000 lekë (përgatitje kërkesë) dhe 500 lekë deri në 1.500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit - shih rubrikat I dhe II të shtojcës 1 “Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike”). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka theksuar se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, për sa kohë që në gjykimin kushtetues individ i kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Kjo logjikë ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren si të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (neni 399/4, pika 2, i Kodit të Procedurës Civile) (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh parashikimet e udhëzimit nr. 18/2020, aktet e përgatitura nga përfaqësuesi i kërkuesit për përfaqësimin e tij në këtë gjykim kushtetues, natyrën

e çështjes konkrete, si dhe numrin e pretendimeve të pranuar, vlerëson se masa e arsyeshme për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore në Gjykatë është në vlerën 30.000 lekë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet pjesërisht.

39. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit duhet të pranohet, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1923 (290), datë 21.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 30.000 (tridhjetë mijë) lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 9.3.2026.

Shpallur më 4.5.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji (kundër)

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marjana Semini, Ilir Toska, Sandër Beci, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket ankimit kushtetues individual të kërkuesit Edmond Hysenaj, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1923 (290), datë 21.11.2024, të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, ne, gjyqtarët në pakicë, Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari dhe



Asim Vokshi jemi kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se pretendimet janë të pabazuara, ndaj kërkesa duhej të ishte rrëzuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashitrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Duke shmangur përsëritjen e fakteve dhe të rrethanave të çështjes, vëmë në dukje se gjykimi kushtetues ka për objekt kontrollin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, e cila ka prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit që ka pranuar disponimin e Prokurorisë së Vlorës për sekuestrimin e akteve të fitimit të pronësisë. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtëm të së drejtës së aksesit, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, si dhe së drejtës së pronës, të garantuara nga nenet 42, 142 dhe 41 të Kushtetutës.

3. Shumica ka vlerësuar se argumentet në thelb të këtyre pretendimeve parashitohen në drejtëm të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosnjohimit të kërkuarit për rekursin e plotë, si dhe së drejtës së pronës, duke i analizuar ato në drejtëm të së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes (*shih paragrafët 20–22 të vendimit*). Në përfundim, shumica e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e kërkuarit për cenimin e këtyre të drejtave (e drejta e aksesit dhe ajo e mbrojtjes), pasi atij nuk i ishte njoftuar rregullisht rekursi i plotësuar, por vetëm rekursi i shkurtuar (*shih paragrafin 31 të vendimit*). Ajo (shumica) ka argumentuar se kërkuari nuk rezulton të jetë njoftuar as personalisht, as nëpërmjet përfaqësuesit të zgjedhur për rekursin e plotë dhe Gjykata e Lartë nuk e ka konstatuar këtë fakt dhe nuk ka arsyetuar nëse ishin përmbushur detyrimet ligjore për njoftimin. Po kështu, njoftimi i datës së seancës nga administrata e Gjykatës së Lartë nuk ishte i mjaftueshëm për të korrigjuar dhe riparuar të metat e evidentuara në drejtëm të njoftimit të plotë të rekursit, fakt që mbeti i paverifikuar nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 30 të vendimit*).

4. Ne, gjyqtarët në pakicë, duke mbajtur në konsideratë, nga njëra anë, standardet kushtetuese të elaboruara edhe nga shumica se njoftimi i akteve me

të cilat vihet në lëvizje një proces gjyqësor ka rëndësi në drejtëm të pjesëmarrjes së individit në gjykim dhe të realizimit të të drejtave të tij kushtetuese (*shih paragrafin 25 të vendimit*) dhe, nga ana tjetër, rrethanat e çështjes, vlerësojmë se jo çdo “gabim” procedural justifikon cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Vetëm gabimet procedurale që pasjellin njëkohësisht dëmtimin serioz edhe të një të drejte substanciale mund të pasjellin cenimin e vendimmarrjes së gjykatave. Cenimi i së drejtës së aksesit në drejtëm të marrjes dijeni nga kërkuari për rekursin e paplotë të ushtruar nga pala tjetër, për mosnjohimin atij individualisht edhe të rekursit të plotësuar, nuk paraqitet i një rëndësie të tillë që të përbëjë shkak për shfuqizimin si antikushtetues të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë.

5. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e respektimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuarin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejtë në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin konkret, mangësia procedurale lidhur me mosnjohimin e rekursit të plotë duhet analizuar në aspektin e ndikimit të saj në të drejtën kushtetuese të mbrojtjes efektive të lidhur me të drejta të tjera procedurale kushtetuese për kërkuarin. Thënë kjo, në rastin në shqyrtim, kërkuari dhe avokati i tij kanë qenë në dijeni se çështja ishte regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë, në bazë të rekursit të paraqitur nga pala tjetër, konform njoftimit të marrë sipas nenit 414 të KPP-së. Pra ata dinin që ishte paraqitur një rekurs, në përmbajtje të



të cilit rekursuesi bënte me dije se do të paraqiste argumente të plota, pasi të njihet me arsyetimin e vendimit të gjykatës së apelit. Kërkuesi, ndonëse kishte të drejtë, nuk ka paraqitur memorie sipas neneve 110 e 435, pika 2 të KPP-së, për t'i bërë me dije dhe kërkuar Gjykatës së Lartë që të vendosej mospranimi i rekursit sipas nenit 433 të KPP-së. Po kështu, pranohet se avokati i kërkuesit ishte njoftuar rregullisht nëpërmjet postës elektronike shumë kohë përpara datës 21.11.2024, për shqyrtimin e çështjes në atë datë nga Gjykata e Lartë, në dhomën e këshillimit, dhe nuk ka depozituar ndonjë memorie në gjykatë, e as është interesuar për ecurinë procedurale të çështjes dhe të rekursit të paplotë të palës tjetër, për të cilin kishte dijeni.

7. Për sa më lart, vlerësojmë se në kushtet e mosinteresimit të palës kërkuese dhe avokatit të saj, për të verifikuar gjendjen e fashikullit dhe çështjes që ishte caktuar për gjykim në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë më 21.11.2024, nuk mund të pretendohet dëmtim substancial i së drejtës së mbrojtjes së kërkuesit. Ushtimi i së drejtës së mbrojtjes presupozon përveç detyrimit të gjykatave që t'i njoftojnë palës dhe avokatit të gjitha aktet procedurale, për të cilat ligji parashikon se duhen njoftuar, edhe qenien aktiv të palës për mbrojtjen e të drejtave të tij procedurale. Pala kërkuese dhe avokati i saj duhej të ishin aktivë në verifikimin e fatit të rekursit, për sa kohë çështja kishte kaluar për shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe ajo kishte rreth 5 vjet e regjistruar në atë gjykatë. Nuk është e paarsyeshme dhe as barrë e tepërt të pritej nga kërkuesi dhe avokati i tij që ata të interesoheshin dhe të kërkonin të shihnin dosjen në gjykatë gjatë këtyre 5 vjetëve që ajo ishte aty në pritje të gjykimit, për të verifikuar nëse ishte plotësuar ose jo rekursi prej rekursuesit dhe t'i kërkonin Gjykatës së Lartë respektivisht mospranimin e tij. Nëse do të kishin ushtruar këtë kujdes minimal dhe që nuk kërkon mundime të paarsyeshme, do të kishin konstatuar lehtësisht se rekursi ishte plotësuar në afat dhe, rrjedhimisht, të realizonin mbrojtjen e tyre nëpërmjet depozitimit të parashtrimeve me shkrim ose memorie, për të kundërshtuar shkaqet e rekursit të ngritura nga rekursuesi përpara seancës së datës 21.11.2024.

8. Nën dritën e kësaj analize, vëmë në dukje se pasaktësia ose gabimi procedural i gjykatave në mosnjoftimin e kërkuesit dhe të avokatit të tij të rekursit të plotësuar me argumente nga rekursuesi,

në rrethanat e kësaj çështjeje, paraqitet i parëndësishëm dhe që nuk ka asgjësuar ose rënduar tej mase mundësinë e ushtrimit efektiv të së drejtës së mbrojtjes nga ana e kërkuesit. E drejta e mbrojtjes, siç u parashtrua më sipër, mbeti praktike dhe efektive, për sa kohë që pala kërkuese e dinte që ishte depozituar rekurs dhe çështja ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë, dhe kjo gjykatë i kishte njoftuar avokatit datën dhe orën e shqyrtimit të saj shumë kohë më përpara. Thënë kjo, është e arsyeshme që, së paku në planin kushtetues, Gjykata të mos i japë peshë çdo gabimi procedural të gjykatave për të cenuar vendimmarrjet e tyre, kur dukshëm këto gabime nuk kanë afektuar seriozisht ushtrimin e të drejtave të garantuara nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

9. Në përfundim, çmojmë se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardet kushtetuese në drejtim të garantimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, mbajtëm qëndrimin se Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Asim Vokshi, Marsida Xhaferllari,

VENDIM

Nr. 235, datë 6.5.2026

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 78, DATË 30.5.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, “PËR KALENDARIN E SHQYRTIMIT TË ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN E APELIT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 89 dhe pika 4, shkronja “e”, të nenit 94, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 460, pika 4, të Kodit të Procedurës Civile, me propozim të anëtarëve Violanda Theodhori, Irena Plaku dhe Markelian Koça, Këshilli i Lartë Gjyqësor

VENDOSI:

Në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e



apelit”, të ndryshuar, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bëhen këto shtesa:

Në kreun II, “Rastet e përshpejtimit të çështjeve”, në pikën 3.1 shtohen shkronjat “nj”, “o” dhe “p” me këtë përmbajtje:

“nj) Çështjet e pronësisë që lidhen me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave ish- pronarëve;

o) Çështjet që lidhen me kontratat konsumatore dhe paditë kolektive për mbrojtjen e konsumatorit;

p) Çështjet me objekt mbrojtjen e mjedisit dhe të klimës.”.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KËSHILLIT
TË LARTË GJYQËSOR
Ilir Rusi

VENDIM
Nr. 17, datë 7.5.2026

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË
TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe të nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) **Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:**

- 184 lekë/litri për gazoilin;
- 168 lekë/litri për benzinën.

b) **Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:**

- 196 lekë/litri për gazoilin;
- 180 lekë/litri për benzinën.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026 “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944 me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin Benzinë sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t’i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t’i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 7.5.2026, ora 12:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me



shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë

